



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr ____prot

Tiranë më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 259, datë 16.05.2024

PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM
GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatore znj. Irena Plaku,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
 2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PWRCAKTIMI I NIVELIT TW VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares {...} Vlorë ({...}) në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtares bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy treguesve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nëntregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi dhe për rrjedhojë nuk është e lidhur as me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e nje ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në vijim, analizohet mënyra se si janë evidentuar këta elementë ligjorë në vendimet burim vlerësimi për gjyqtaren {...}.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe vendimet e administruar për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “...Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për zbatimin e saj në rastin konkret...Në të drejtën civile, gjyqtare {...} Vlora, zgjidh drejt çështjet objekt gjykimi dhe vendimet e dhëna prej saj, pjesa dërrmuese lihet në fuqi nga gjykatat më të larta, ose nuk ankimohet nga palët (shih dokumentat 1-3 dhe dosjet 1, 3, 4 dhe 5). Përrjashtimisht konstatohet një vendim i cënuar pjesërisht nga Gjykata e Apelit Tiranë, që i përket dosjes nr. 2. Në këtë rast, apeli ndryshoi pjesërisht vendimin e dhënë nga znj. Vlora. Apeli konsideroi të gabuar zbatimin e dispozitave mbi vlefshmërinë e testamentit nga gjyqtare Vlora, pasi argumentoi se testatori kishte disponuar pasurinë e tij përtej radhëve të trashëgimisë ligjore të përcaktuara në nenin 377 të K.Civil, fakt që e bënte atë të pavlefshëm, ndryshe nga znj. Vlora që e konsideroi të vlefshëm testamentin në atë rast. Gjithashtu, në të drejtën civile, gjyqtare Vlora ka njohuri shumë të mira në lidhje me paditë për shpërblimin e dëmitpasuror dhe jopasuror. Në rastin e dëmit jopasuror, njeh saktë të tre llojet e tij atë biologjik, moral dhe ekzistencial (shih dokumentin nr. 2); për pavlefshmërinë e testamentit në rastet kur është cënuar rezerva ligjore (shih dokumentin nr. 3); për kërkimin e pasurisë trashëgimore (shih dosjen nr.3)”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- ***Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes ;***

Referuar burimeve të vlerësimit (*vendimeve civile themeli apo kërkesa në fazën e hetimeve paraprake*), rezulton se gjyqtarja në disa vendime ka parashtruar në mënyrë të përmbledhura faktet e çështjes, në fillim të pjesës arsyetuese të vendimit, menjëherë pas paraqitjes së padisë me të cilën pala paditëse i është drejtuar gjykatës, duke i gërshetuar në disa raste me aktet provuese që provojnë faktet konkrete¹. Ndërsa në disa vendime, konkretisht tek dy çështjet me objekt marrëdhënie pune², tek vendimi me objekt

¹ Vendimi nr10342, datë 28.10.2014, vendimi nr.7979, datë 14.07.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

² Vendimi nr.8615, datë 08.09.2014 dhe vendimi nr.4358, datë 27.05.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

përmbushje detyrimi³, tek vendimi me objekt njohje vërtetësi shënimesh, gjyqtarja ka pasqyruar vetëm disa nga faktet e çështjes, konkretisht vetëm në lidhje me ekzistencën së marrëdhënies juridike të punës apo të ekzistencës së kontratës, ndërsa faktet e tjera të çështjes janë përshkruar dhe analizuar tek pjesa e analizës juridike. Tek dy vendimet me objekt shpërblim dëmi pasuror dhe jo pasuror faktet e çështjes janë përshkruar sipas rezultateve të hetimit të kryer nga prokuroria apo vendimit të gjykatës për dëminin e të pandehurit. Ndërsa në pjesën tjetër të vendimeve burim vlerësimi, gjyqtarja nuk bën përshkrim të fakteve siç kanë rezultuar nga provat por e fillon arsyetimin me parashtrimin e pretendimeve të palëve lidhur me faktet dhe arsyetimin ligjor të pretendimeve të tyre. Në të gjithë këto vendime burim vlerësimi faktet përshkruhen dhe analizohen në raport me njëra tjetrën tek pjesa e analizës juridike, duke i gërshetuar edhe me aktet provuese që provojnë faktet konkret, fakte këto që nuk janë përshkruar më parë në fillim të pjesës përshkruese – arsyetuese, rrethanë kjo që nuk i jep qartësi vendimin për faktet e provuara në gjykim.

Tek vendimi me objekt vleftësim arresti caktim mase sigurimi personal, faktet e çështjes përshkruhen sipas përshkrimit të bërë nga organi i akuzës, dhe mënjherë pas pasqyrimin të tyre si dhe të pretendimeve të prokurorisë lidhur me bazueshmërinë e kërkesës paraqiten konkluzionet për kërkimet se janë të mbështetura në ligj, pa u bërë një analizë e tyre.

Ndërsa rezultoi se, rrethanat procedurale të çështjet nuk janë përshkruar dhe arsyetuar në asnjë nga vendimet burim vlerësimi, si vlerësimi në lidhje me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore, dhe as në lidhje me ecurinë procedurale të çështjes lidhur me paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë, të kërkesës për saktësimin apo shtimin e objektit të padisë, të cilat duken se janë marrë në shqyrtim gjatë procesit.

- ***Identifikimi i natyrës së çështjes:***

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik (i cili jo gjithmonë përshkruhet i plotë nga gjyqtarja në pjesën e parë të pjesës përshkruese- arsyetuese të vendimit), gjyqtarja krijon idenë e saj rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve. Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarës, duke u bërë përgjithësisht në mënyrë të shprehur, e në disa raste, si pasojë e një analize ligjore të shkakut dhe objektit të padisë.

Pas përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike, gjyqtarja përcakton drejt edhe institutin juridik përkatës të çështjes civile (*nëse jemi para një mosmarrëveshje juridike civile detyrimi, pavlefshmëri titulli juridik, pavlefshmëri testamenti, marrëdhënie pune apo shpërblim dëmi etj*). Nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtarja dhe

³ Vendimi nr.5209, datë 16.06.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

atyre të përzgjedhura me short, vihet re që natyra juridike e çështjes është evidentuar pothuajse në të gjitha çështjet e trajtuara, por edhe ku nuk është identifikuar në mënyrë specifike, del qartë referuar identifikimit të elementeve dhe kriterëve ligjore të mosmarrëveshjes juridike.

- ***Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm:***

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes (të cilat siç u tha më lartë asnjëherë nuk janë marrë në shqyrtim në mënyrë të shprehur nga ana e gjyqtare), por lidhet gjithashtu edhe me identifikimin e ligjit të zbatueshëm procedural dhe material në zgjidhjen e çështjes. Në këtë drejtim, rezulton se në të gjitha vendimet, gjyqtarja identifikon ligjin e zbatueshëm që ajo referon në zgjidhjen e çështjes, citon dispozita të ligjit material ose procedural, si dhe analizon përmbajtjen e tyre, kur është vlerësuar e nevojshme, në mënyrë të integruar me faktin, ose në disa raste në mënyrë të pavarur, para aplikimit mbi faktet e çështjes.

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, rezulton se gjyqtarja identifikon dhe/ose citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në mos citimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë drejtpërdrejt në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Konkretisht, gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes duke iu referuar si dispozitave materiale të Kodit Civil, Kodit të Punës ashtu edhe ligjeve organike përkatëse, që kanë lidhje kryesisht me:

- i. *Padia për pavlefshmërinë e testamentit*, ku gjyqtarja identifikon ligjin e zbatueshëm nenet 316 e në vijim të Kodit Civil duke u ndalur tek përcaktimi ligjor i testamentit (neni 316 i KC), koha e çeljes së trashëgimisë, zotësia për të trashëguar, padenjësia për të trashëguar, koha e fitimit të trashëgimisë, posedimi i pasurisë trashëgimore (neni 318, 320, 322, 330, 331, KC). Gjithashtu gjyqtarja për analizimin sa më të saktë të çështjes ndalet në rregullat për përfitimin e trashëgimisë, në caktimin e trashëgimtarit, në konceptin e “përrjashtimit nga trashëgimia” dhe në rezervën ligjore dhe në përfitimin e trashëgimisë me zëvendësim (nenet 361/2, 377, 378, 379 dhe 381 të KC) si dhe në lidhje me pavlefshmërinë e veprimeve juridike që vijnë në kundërshtim me dispozitat urdhëruese të ligjit, afati i parashkrimit të padisë, pasojat e pavlefshmërisë së veprimit juridik, rastet e pavlefshmërisë së testamentit, në padinë për kërkimin e trashëgimisë si dhe në lidhje me parashkrimin e padisë për pavlefshmërinë e testamentit (nenet 72- 92/a, 103, 111, 349, 350, 406, 407, 411 të KC)⁴. Në një tjetër vendim⁵ me objekt të njëjtë, gjyqtarja, përveç citimit të nenëve që rregullojnë testamentin (si më sipër), ndër të tjera ndalet tek veprimet që shpallen të pavlefshme (neni 94, 95, 105 KC), pamundësia për të tjetërsuar pronën e paregjistruar (neni 195 KC), detyrat e poseduesit me keqbesim (neni 298 KC) Përveç Kodit Civil, gjyqtarja i referohet edhe ligjeve të posaçme siç është ligji 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” duke referuar edhe ndryshimet që ka pësuar ky ligj, si dhe në VKM nr. 258, datë 04.05.2007 në lidhje me regjistrimin

⁴ Vendim nr. 7979, datë 14.07.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁵ Vendim nr. 10342, datë 28.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

filleshtar të pasurive të paluajtshme⁶. Në një tjetër vendim⁷ me objekt të ngjashëm, gjyqtarja, përveç citimit të nenëve që rregullojnë testamentin (si më sipër), ndër të tjera ndalet trajtimi i vendimit të KKK Pronave me të cilin i është kthyer prona palëve ndërgjyqëse si dhe në ligjin e kohës nr 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve” në lidhje me vendimet e ankimeshme në gjykatë (neni 27/a).

- ii. *Zgjidhjen e kontratës së punës*, duke cituar nenin 141 të K.Punës për të përcaktuar mënyrën e përfundimit të kontratës së punës me afat të caktuar, nenin 143 të K.Punës në lidhje me afatet e zgjidhjes së kontratës së punës me afat të pacaktuar, nenin 151/1 të K. Punës në lidhje me kontratat e njëpasnjëshme me afat të caktuar, nenet 153 dhe 155 në lidhje me shkaqet e justifikuar dhe të pajustificuar të zgjidhjes së menjëhershme të kontratës së punës dhe e drejta e punëmarrësit për pagën si dhe nenin 145 të K.Punës në kuadër të shpërblimit për vjetërsi pune;⁸
- iii. *Pavlefshmërinë e titujve ekzekutiv të faturave të energjisë elektrike dhe të ujit të pijshëm*, ku gjyqtarja identifikon dispozitat ligjore materiale dhe procedurale (*nenin 609 të K.Pr.Civile*), në lidhje me normën ligjore të zbatueshme për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv në funksion të analizës lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes. Gjyqtarja identifikon dispozita të Kodit të Matjes së energjisë elektrike miratuar me vendimin nr. 101, datë 26.08.2008 të ERE, në drejtim të përcaktimit të faturës së shitjes së energjisë si titull ekzekutiv.⁹ Gjyqtarja identifikon dispozita të VKM 1304/2009 në lidhje me afatet brenda të cilëve kundërshtohet vlerat e faturës së ujit të pijshëm, në drejtim të përcaktimit të faturës së shitjes së ujit të pijshëm si titull ekzekutiv¹⁰.
- iv. *Detyrimin për shpërblim dëmi*, ku gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm nenet 419, 420 të K.Civil në lidhje me detyrimet dhe burimet e tyre si dhe nenin 690 të K. Civil në lidhje me forcën detyruese të kontratës¹¹; nenin 70 të K.Pr.Penale në lidhje me rastet kur vendimi penal i formës së prerë është i detyrueshëm në gjykimin civil, nenet 608, 609, 618 dhe 622 të K.Civil në lidhje me përgjegjësinë mbi shkaktimin e dëmit jashtëkontraktor si përgjegjësi me faj dhe rastet përjashtimore¹²; ligjin 9267/2004 në lidhje me termin “ngjarje e siguar”, ligjin 10076 datë 12.02.2009 si dhe rregulloren nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit” miratuar nga Bordi i Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare si bazë ligjore për zgjidhjen e çështjes. Gjithashtu gjyqtarja identifikon nenet 625/a, 643/a/b në lidhje me përcaktimin e dëmit biologjik dhe pasuror. Ndërsa në lidhje me fuqinë e ligjeve dhe akteve nënligjore dhe hyrjes në fuqi të tyre, gjyqtarja identifikon nenet 117 dhe 118 të Kushtetutës¹³.
- v. *Padinë për pjesëtimin e pasurisë faza e parë* në të cilën, gjyqtarja për të identifikuar pasuritë që i nënshtrohen pjesëtimin, rrethin e bashkëpjesëtarëve dhe pjesët takuese të secilit, i referohet përveç nenit 370 të K.Pr.Civile edhe ligjit nr. 601, datë 18.05.1948 “Mbi martesën”, dispozitat tranzitore të tij, dekretit nr. 2083/1955 “Mbi pronësinë” si dhe nenin 352/2 të Kodit Civil të vitit 1981 (hyrë në fuqi më 01.01.1982). Gjyqtarja identifikon rregullimin që Kodi Civil i vitit 1981 i bën marrëdhëniet të pronësisë të lindura para hyrjes në fuqi të tij¹⁴.
- vi. *Në padinë për njohjen e vërtetësisë së dokumentit*, gjyqtarja identifikon nenin 32/c të K.Pr.Civile për zgjidhjen e çështjes¹⁵.

⁶ Vendim nr. 7979, datë 14.07.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁷ Vendim nr. 10349, datë 18.10.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁸ Vendimi nr.4358, datë 27.05.2015 dhe vendim nr. 8615, datë 08.09.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁹ Vendimi nr.6751, datë 17.09.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁰ Vendimi nr.4009, datë 15.05.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹¹ Vendimi nr.5209, datë 16.06.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹² Vendimi nr.3198, datë 18.04.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹³ Vendimi nr.5685, datë 07.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁴ Vendimi nr. 9403, datë 04.11.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁵ Vendimi nr.10757, datë 30.10.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Në vendimet gjyqësore evidentohet citimi dhe analiza e dispozitave procedurale civile në lidhje me rastet kur vendimi merr formë të prerë (*neni 451 i K.Pr.Civile*)¹⁶, nenin 370 në lidhje me pjesëtimin e pasurisë në fazën e parë¹⁷ dhe nenin 371 të K.Pr.Civile në lidhje me pjesëtimin e pasurisë në fazën e dytë të gjykimit¹⁸. Në të gjitha rastet e sipërpërmendura, është disponuar lidhur me kërkesat procedurale në përputhje me faktin, provat dhe dispozitën relevante procedurale përkatëse.

Në çështje të fazës së hetimit paraprak me objekt “*Vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi*”, gjyqtarja identifikon nenet 251, 252 dhe 228, 229 të K.Pr.Penale lidhur me kushtet ligjore të arrestimit në flagrancë dhe kushtet dhe kriteret ligjore për caktimin e masave të sigurimit personal, por jo përmbajtjen e tyre.¹⁹

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret.

KONKLUZIONI

Në tërësi nga burimet e vlerësimit, rezulton aftësia e gjyqtarës për paraqitjen dhe analizën e plotë të fakteve thelbësore të çështjes të cilat përgjithësisht paraqiten në mënyrë të përmbledhur, duke i integruar në disa raste dhe provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Por këto fakte jo gjithmonë janë përshkruar në pjesën e parë të pjesës arsyetuese- përshkruese të vendimit, duke u përshkruar dhe analizuar tek pjesa e analizës juridike të çështjes, fakte të cilat nuk janë përshkruar më parë. Në pjesën e analizës, gjyqtarja integron provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Ndërsa rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin e “*Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin normave*” vlerësohet “*Mbi mesatare*” dhe pikëzohet me 20 pikë.

¹⁶ Vendimi nr. 10342, datë 28.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁷ Vendimi nr. 9403, datë 04.11.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁸ Vendimi nr. 11213, datë 11.11.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁹ Vendimi nr.1162, datë 26.05.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet t'i japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe vendimet e administruar për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Subjekti i rivlerësimit {...} Vlora ({...}) përgjithësisht ka shfaqur aftësi shumë të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj, janë të qarta të kuptueshme, qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar, provat e marra në shqyrtim jo vetëm citohen, por edhe tregohet se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse, i jepet përgjigje ligjore pretendimeve apo prapësimeve/kundërshtimeve të palëve të parashtruara gjatë gjykimit, duke treguar se gjyqtarja ka qenë e vëmëndshme ndaj kërkesave të tyre...Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara, respekton standartin e procesit të rregullt ligjor. Vendimet e ndërjetme gjithashtu shoqërohen me referencë ligjore dhe kur duhet jepen arsye për dhënien e tyre (shih 5 dosjet e vëzhguara). Përgjithësisht në arsyetimin e vendimit, kemi konstatuar mangësi në dosjen nr. 5. Në analizën që i kemi bërë vendimit që i përket dosjes nr. 5, kemi evidentuar si mangësi faktin që në atë vendim, parashtrohet vetëm qëndrimi dhe argumentat e prokurorit dhe nuk thuhet asgjë për qëndrimin dhe argumentat e avokatit dhe personit nën hetim ndaj dy kërkesave të prokurorit...”*

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:***

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*kryesisht asaj materiale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Përgjithësisht normat ligjore citohen duke u shoqëruar

me interpretimin e tyre herë konciz e herë më të detajuar në varësi të kompleksitetit të argumentit që shtjellohet. Në të shumtën e rasteve normat ligjore citohen të plota. Ka raste që gjyqtarja është përsëritëse në argumentim, gjë që e bën më pak të rrjedhshëm leximin.

Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarës sipas mënyrës së interpretimit të tyre, në funksion të analizës juridike dhe të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në këtë kontekst, konstatohet se gjyqtarja kryesisht interpreton normën ligjore konkrete ndaj faktit juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, duke nxjerrë konkluzionin e saj në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Karakteristikë e gjyqtarës është fakti që pas analizimit të një sërë dispozitash, përcakton shprehimisht dispozitat e vlefshme për zgjidhjen e çështjes.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm

Në vendimet e analizuara përgjithësisht, interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj, duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim.

Konkretisht, në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se gjyqtarja:

- a) interpreton dispozitat ligjore materiale në lidhje me paditë për pavlefshmërinë e testamentit. Në mënyrë specifike analizon nenet 378 dhe 379 të K.Civil ku ndalet në llojet e përjashtimit nga trashëgimia dhe cënimi i rezervës ligjore²⁰; nenin 363 të K.Civil në lidhje me kushtet që duhet të plotësojë një person i paaftë për punë që të përfitojë nga trashëgimia, nenet 92, 94 e 95 të K.Civil duke interpretuar veprimet juridike absolutisht të pavlefshme dhe relativisht të pavlefshme, ndryshimet mes tyre dhe zbatimin në rastin konkret, duke u ndaluar në efektet prapavepruese të nenit 105 ku veprimi që shpallet i pavlefshëm quhet i tillë që nga çasti kur është kryer²¹;
- b) Interpreton nenin 609 të K.Pr.Civile si një nga mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit të titujve ekzekutivë duke analizuar kushtet që duhet të përmbushë debitori për të këkuar pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv si dhe dispozita të Kodit të Matjes së energjisë elektrike miratuar me vendimin nr. 101, datë 26.08.2008 të ERE, në drejtim të përcaktimit të faturës së shitjes së energjisë si titull ekzekutiv.²² Gjyqtarja analizon dhe zgjidh çështjen bazuar në dispozitat e VKM 1304/2009 në lidhje me afatet brenda të cilëve kundërshtohet vlerat e faturës së ujit të pijshëm, në drejtim të përcaktimit të faturës së shitjes së ujit të pijshëm si titull ekzekutiv²³;
- c) Interpreton nenin 151/1 të K.Punës në lidhje me kushtet që duhet të plotësojnë kontratat e lidhura me afat të caktuar për t'u konsideruar si kontratë me afat të caktuar duke e nderthuar me faktet konkrete të çështjes në gjykim²⁴ si dhe nenin 153 të K Punës në lidhje me shkaqet e justifikuara

²⁰ Vendim nr. 7979, datë 14.07.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²¹ Vendim nr. 10342, datë 28.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²² Vendimi nr. 6751, datë 17.09.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²³ Vendimi nr. 4009, datë 15.05.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁴ Vendim nr. 8615, datë 08.09.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

- për zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës duke analizuar shkaqet konkrete në ngarkim të punëmarrësit për të cilat është bërë dhe zgjidhja e menjëhershme e kontratës së punës²⁵;
- d) Interpreton frymën e ligjit nr. 601, datë 18.05.1948 “Mbi martesën”, si dhe nenet 84, 85, 86, 87 dhe 89/3 të Kodit Civil të vitit 1981 në lidhje me përcaktimin e bashkëpronarëve, pjesëve takuese të gjithësecilit dhe më pas pjesëtimin e pasurisë duke marrë në konsideratë deklaratat para organeve kompetente²⁶;
 - e) Interpreton nenin 26 të ligjit ligjin 9267/2004 dhe rregulloren nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit” miratuar nga Bordi i Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare si bazë ligjore për zgjidhjen e çështjes në lidhje me termin “ngjarje e siguar”, duke përcaktuar kufijtë minimalë të mbulimit të dëmit dhe llojet e dëmit të shaktuar (pasuror dhe jopasuror)²⁷;
 - f) Interpreton nenet 618 dhe 622 të K. Civil në lidhje me përgjegjësinë mbi shkaktimin e dëmit jashtëkontraktor si përgjegjësi me faj dhe rastet përjashtimore kur veprimtaria e kryer është e rrezikshme nga natyra e saj apo sendet e përdorura, si raste që mund të përjashtojnë personin nga përgjegjësia. Gjyqtarja arrin në përfundimin që nuk jemi në kushtet e nenit 622²⁸;

- ***Në lidhje me interpretimin e dispozitave procedurale***

Gjyqtarja në varësi të natyrës së çështjes, si dhe qëndrimit të saj për aspekte procedurale të çështjes, ka interpretuar në përputhje me rrethanat e faktit apo ato procedurale dispozita të caktuara të Kodit të Procedurës Civile, duke dhënë kuptimin e tyre referuar qëllimit të dispozitës dhe më pas duke e aplikuar mbi faktin/rrethanën konkrete mbi të cilin ajo gjen zbatim. Konkretisht, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi, sa i përket interpretimit të ligjit procedural, rezulton se gjyqtarja:

(i) Interpreton nenin 32/c të K.Pr.Civile në lidhje me padinë për njohjen e vërtetësisë apo të pavërtetësisë së një dokumenti, si bazë ligjore për zgjidhjen e çështjes²⁹;

(ii) Interpreton nenet 370 të K.Pr.Civile në lidhje me pjesëtimin e pasurisë në fazën e parë³⁰ dhe nenin 371 të K.Pr.Civile në lidhje me pjesëtimin e pasurisë në fazën e dytë të gjykimit³¹.

- ***Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante***

Evidentohet se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Civil dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese*) në mbështetje të argumenteve për interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij, në shumicën e vendimeve të analizuara. Konkretisht, në lidhje me: (i) në lidhje me interpretimin e dispozitave të përgjithshme të shpërblimit të dëmit, në mungesë të rregullimit në mënyrë të detajuar nga legjislativi i kësaj fushe gjyqtarja citon vendimin nr. 12, datë 14.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe vendimin nr.

²⁵ Vendimi nr.4358, datë 27.05.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁶ Vendim nr. 9403, datë 04.11.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁷ Vendimi nr.5685, datë 07.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁸ Vendimi nr.3198, datë 18.04.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁹ Vendimi nr.10757, datë 30.10.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³⁰ Vendim nr. 9403, datë 04.11.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³¹ Vendim nr. 11213, datë 11.11.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

2/2012 të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me fuqinë e Rregullores 53/2009³²; (ii) zbatimin e legjislacionit përkatës në lidhje me regjimin pasuror mes bashkëshortëve citon vendimin unifikues nr.5, datë 20.01.2009³³; (iii) momentin e kalimit të pronësisë së një pasurie të paluajtshme dhe efektet e regjistrimit të pasurisë në regjistrat publikë citon vendimin unifikues nr. 1/2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendimet nr. 13/2006 dhe 5/2012 në lidhje me veprimet juridike absolutisht të pavlefshëm si dhe vendimin nr. 3/2012 që i njej gjykatës të bëjë një cilësim juridik të ndryshëm mosmarrëveshjes civile nga ajo që i bën paditësi .³⁴

- Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës

Gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, gjyqtarja përmend dhe zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsyetimit dhe konkluzionit të arritur. Gjyqtarja njej dhe zbaton parimet procedurale gjatë gjykimit siç janë:

- (i) *Parimin e procesit të rregullt ligjor*, pasi referuar kontekstit të arsyetimit të vendimeve, rezulton të jenë zbatuar drejtpërdrejt aspekte të tij në lidhje me respektimin e të drejtave procedurale të palëve ndërgjyqëse, aksesin në gjykatë, kontradiktoritetin, të drejtën e disponimit të padisë, barrën e provës,...etj.
- (ii) *Parimin e hierarkisë së normave*, ku ligji i posaçëm prevalon mbi atë të përgjithshëm (në këtë rast Kodi Civil).³⁵
- (iii) *Parimi i përgjithshëm i përgjegjësisë në shkaktimin e dëmit jashtëkontraktor si një përgjegjësi me faj*, të sanksionuara në nenin 608 e vijues të Kodit Civil.³⁶

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja përgjithësisht ka shfaqur aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen, interpretim që bëhet si në aspektin abstrakt ashtu edhe në raport me faktet e çështjes dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës.

³²Vendimi nr.5685, datë 07.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³³Vendim nr. 9403, datë 04.11.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³⁴Vendim nr. 10342, datë 28.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³⁵Vendimi nr.5685, datë 07.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³⁶Vendimi nr.3198, datë 18.04.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballlet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ është shprehur se, megjithëse gjykatave i lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përse i përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për tu ankuar³⁷.

Gjyqtari duhet të ketë në konsideratë se e tërë dija e tij profesionale do të ketë vlerë nëse vendimi i tij është hartuar në një gjuhë të thjeshtëzuar dhe të kuptueshme.

Shkrimi ligjor duhet të karakterizohet nga disa tipare që e bëjnë të qëndrueshëm, siç janë: qartësia, saktësia, konciziteti dhe komponenti analitik. Ai duhet të paraqesë pa ndërprerje një pamje të qartë, të shpejtë dhe të plotë të çështjes. Vendimi gjyqësor nuk duhet të dominohet nga përshkrimi i provave, por nga pjesa analitike, e cila në vetvete duhet të jetë koncize, pa përsëritje dhe të trajtojë çështjet thelbësore.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe vendimet e administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se; “*Subjekti i rivlerësimit {...} Vlora {...} përgjithësisht ka shfaqur aftësi shumë të mira në arsyetimin*

³⁷ Vendimi i GJEDNJ, Çështja Dadjanastassion vs Greqisë, datë 16.12.1992, faqe 33.

ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj, janë të qarta, të kuptueshme, qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar, provat e marra në shqyrtim jo vetëm citohen, por edhe tregohet se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse, i jepet përgjigje ligjore pretendimeve apo prapësimeve/kundërshtimeve të palëve të parashtruara gjatë gjykimit, duke treguar se gjyqtarja ka qenë e vëmendshme ndaj kërkesave të tyre”.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe vendimet përfundimtare është përgjithësisht e qartë dhe e kuptueshme për pjesëmarrësit në proces, si dhe për lexuesin.

Termet teknikë janë përdorur në mënyrë korrekte dhe vetëm në rastet kur përdorimi i tyre është i pashmangshëm, duke iu referuar ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që zbatohen mbi marrëdhënien objekt gjykimi.

Në referimin e instituteve dhe parimeve të së drejtës gjyqtarja i përmend ato në arsyetim duke i cituar në gjuhën shqipe, pa krijuar konfuzion për kuptimin e tyre për lexuesin. Nuk evidentohet përdorim i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

Gjyqtarja përgjithësisht përdor të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe (përveç shkronjës “ë” dhe “ç”), respekton rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës, dhe vendimet janë shkruara përgjithësisht në mënyrë korrekte në aspektin gjuhësor. Në vendimet burim vlerësimi, konstatohet se jo gjithmonë gjyqtarja përdor rregullat gramatikore në drejtshkrimin e saktë të fjalëve, kryesisht në mospërdorimin e rregullt të shkronjave të mëdha në fillim të fjalisë, në përdorimin e pasaktë të shenjave të pikësimit dhe fillimit të fjalisë në kryeradhën etj. Konstatohet se pjesa arsyetuese përshkruese fillon gjithmonë me shkronjë të vogël dhe kjo karakteristikë e gjyqtarës shikohet në disa raste edhe në vijim të pjesën përshkruese-analizuese.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare, ndonjëherë të gjata, duke shprehur mendimin përgjithësisht në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme dhe duke organizuar fjalitë në rrjedhë logjike me njëra-tjetrën, por që ndonjëherë qartësia dhe rrjedha e mendimit humbet nga fakti i mosndërtimit të saktë të fjalive, përsëritja dhe nga mungesa e paragrafëve të mirëdallueshëm. Kjo mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit në arsyetimin e vendimeve e vështirëson disi rrjedhshmërinë e vendimit, duke humbur në disa raste filli logjik.

Në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së vendimit, veç pjesës hyrëse dhe përshkruese-arsyetuese të vendimit, evidentohet se në dispozitivin e vendimit gjyqtarja shprehet në mënyrë të plotë dhe koncize për të gjitha kërkimet e objekti të padisë në rastet e pranimit të

saj, për lëshimin e urdhrit të ekzekutiv në paditë e detyrimit, shpenzimet gjyqësore, të drejtën e ankimit, afatin e ankimit dhe momentin e fillimit të tij.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja përgjithësisht i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të kuptueshmërisë për lexuesin. Por nuk konstatohet e njëjta rëndësi në drejtim të koncizitetit dhe qartësisë së vendimit, pasi në disa raste konstatohet përdorimi i fjalive tepër të gjatë, në të cilat humbet filli dhe bëhen tepër të lodhshme për një lexues të zakonshëm. Në mungesën e koncizitetit ndikon edhe mospërdorimi i saktë i rregullave gramatikore në ndërtimin e fjalive dhe përsëritja e mendimit në disa pjesë të vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Mbi mesataren” dhe pikëzohet me 12 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRËORGANIZUAR E VENDIMIT

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kryesore të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsytimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj, të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe vendimet e administruar për shkak të ankesave*);

- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “...Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsytimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standartizuar. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normave ligjore... Përynjshimisht në arsytimin e vendimit, kemi konstatuar mangësi në dosjen nr. 5. Në analizën që i kemi bërë vendimit që i përket dosjes nr. 5, kemi evidentuar si mangësi faktin që në atë vendim, parashtrohet vetëm qëndrimi dhe argumentat e prokurorit dhe nuk thuhet asnjë gjë për qëndrimin dhe argumentat e avokatit dhe personit nën hetim ndaj dy kërkesave të prokurorit...”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Gjyqtarja në hartimin e vendimit përgjithësisht ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, të cilës i përmbahet në prezantimin e fakteve në lidhje themelit të çështjes (jo atyre me natyrë procedurale), identifikimit të ligjit të zbatueshëm, argumentimin ligjor dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Megjithëse konstatohet se gjyqtarja ndjek përgjithësisht një metodologji strukturimi të pjesëve përbërëse të vendimit edhe pse jo në aspektin formal të saj, nuk konstatohet e njëjta metodologji strukturimi tek secili vendim. Në disa vendime burim vlerësimi mungon pasqyrimi i rrethanave të faktin³⁸ siç kanë rezultuar gjatë gjykimit, të cilat më pas përshkruhen dhe analizohen tek pjesa e analizës apo argumentit logjik mbi faktet e çështjes dhe pretendimet e palëve, duke filluar arsytimin direkt me pasqyrimin e pretendimeve të palëve, apo dhe me citimin e provave të paraqitura prej palës paditëse, për të vijuar me arsytimin e saj mbi bazueshmërinë e këtyre pretendimeve në prova dhe në ligj. Gjithashtu, në vendimin me objekt vlefësim arresti, caktimi mase sigurimi personal, faktet pasqyrohen vetëm sipas përshkrimit të bërë nga organi i prokurorisë për të vijuar pas përshkrimit të kërtimeve të prokurorisë me konkluzionet mbi bazueshmërinë në ligj të këtyre kërkesave, duke mos bërë një përshkrim të fakteve siç kanë rezultuar nga provat e paraqitura, si dhe duke mos pasqyruar dhe më pas marrë në analizë pretendimet e të pandehurit, si dhe analizën ligjore në raport me këto fakte e pretendime.

Sa i përket aspektit formal, në pjesën më të madhe të vendimeve, arsytimi paraqitet si një i tërë (jo gjithmonë e ndarë në paragrafë të mirëdallueshëm), me fjali ndonjëherë tepër të gjata, sidomos tek pjesa që gjejnë pasqyrim rrethanat e faktet dhe pretendimet e palëve, të

³⁸ Vendimi nr.10349, datë 18.10.2013, nr.8615 datë 08.09.2014, nr.6751, datë 17.09.2015, nr.4009, datë 15.05.2015 nr.5209, datë 16.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

cilat e bëjnë jo gjithmonë të lehtë kuptimin e tij.

Vendimet përfundimtare, në aspektin strukturor kryesisht janë ndërtuar sipas një modeli të njëjtë, duke evidentuar qartë tri pjesët përbërë së vendimit (*pjesa hyrëse, arsyetimi, pjesa urdhëruese*) sipas parashikimeve të nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile.

Në pjesën hyrëse të vendimit gjen pasqyrim trupi gjykues që ka dhënë vendimin, sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët ndërgjyqëse (*me të dhënat për gjeneralitetet, adresën dhe përfaqësimin në gjykatë*), objekti i mosmarrëveshjes dhe kërkimet përfundimtare të palëve ndërgjyqëse të cilat kanë qenë prezent të përmbledhura në një fjali.

Pjesa përshkuese-arsyetuese e vendimit organizohet në një strukturë të qëndrueshme dhe unike, por jo gjithmonë e ndarë në paragrafë sipas një rrjedhe logjike apo e ndarë në pjesë apo në pjesë me tituj apo me fjali hyrëse përshkuese. Mënyra e organizimit të pjesës përshkuese-arsyetuese të vendimeve burim vlerësimin ndjek përgjithësisht këtë renditje:

- (i) *prezantimi e çështjes* ku përgjithësisht e cilëson që jemi përpara një çështje civile dhe prezantimin e padisë me të cilën paditësi i është drejtuar gjykatës. Gjyqtarja nuk bën një prezantim të ecurisë procedurale të çështjes, nuk evidentohen kërkesat e parashtruar nga palët gjatë gjykimit si dhe vendimmarrjet e ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit si p.sh. në rastin e shqyrtimit të kërkesës për sigurimin e padisë³⁹, pranimin për ndryshimin apo shtimin e objektit të padisë, apo pushimin e gjykimit për disa nga kërkimet për shkak të heqjes dorë nga pala paditëse, etj, të cilat në disa raste janë të nevojshme të përshkruhen dhe arsyetohen në shërbim të qartësisë së vendimit si për palët pjesëmarrëse në gjykim ashtu dhe për gjykatat më të larta, në rastet kur do të shqyrtohet çështja për shkak të ankimit. Kështu, në vendimet nr.6751, datë 17.09.2015 dhe nr.7979, datë 14.07.2014 (i përzgjedhur nga gjyqtarja, nuk del qartë objekti i saktë i padisë i pasqyruar në pjesën hyrëse të vendimit, për kë nga këto kërkime është pushuar gjykimi me kërkesë të palës paditëse (kur në fund të vendimit gjyqtarja citon se për kërkimet e tjera padia është pushuar me kërkesë të palës paditëse), momenti procedural se kur këto kërkime janë pushuar.
- (ii) *Rrethanat e faktit*. Rezulton që prezantimi i faktit në disa raste është i qartë dhe konciz, ku herë pas herë referohen dhe provat e administruara dhe të marra në shqyrtim. Ndërsa në disa vendime, gjyqtarja nuk bën një prezantim të përmbledhur të rrethanave dhe provave në pjesën e parë të vendimit, duke e filluar arsyetimin me paraqitjen e pretendimeve të palëve, që në disa raste paraqiten në mënyrë të detajuar kërkimet e tyre në raport me faktet e çështjes dhe se si gjen zbatim ligji në rastin konkret, për të vijuar më pas me analizën ligjore të çështjes në raport me rrethanat e çështjes dhe provave të marra në shqyrtim.
- (iii) *Pretendimet e palëve*. Në shumicën e vendimeve gjejnë pasqyrim pretendimet e palëve, provat e referuara nga ana e tyre, si dhe referencat ligjore mbi të cilat mbështeten pretendimet e tyre, të cilat në disa raste paraqiten në mënyrë të përmbledhur dhe në disa raste në mënyrë më të detajuar. Ndërsa në vendimin për vleftësim arresti dhe caktim mase mungon tërësisht paraqitja e pretendimeve të të pandehurit lidhur me kërkesat e paraqitura nga prokuroria, ku këto të fundit janë pasqyruar në mënyrë të detajuar.

³⁹ Vendimi nr.10349, datë 18.10.2013 I Gjykatës së Rethit Gjyqësor Tiranë.

(iv) *Vlerësimi i gjykatës* lidhur me çështjen (*edhe pse në vendime nuk gjendet me këtë titull*). Pas evidentimit të fakteve të çështjes, në ato raste kur ato evidentohen qartë, si dhe përshkrimit të pretendimeve të palëve, arsyetimi vijon me analizën mbi faktet konkrete, duke e gërshetuar arsyetimin me referimin në ligjin procedural dhe material të zbatueshëm, zbërthimin dhe analizën e tij, duke evidentuar kushtet e nevojshme që duhet të plotësohen në rastin konkrete dhe përqasjen e tij me faktet e provuar në gjykim, për të vijuar me konkluzionin lidhur me bazueshmërinë ose jo në ligj të padisë. Pjesë e analizës ligjore, janë edhe pretendimet e palëve të cilat merren në analizë lidhur me ligjin dhe me faktet e provuara. Në përfundim të analizës ligjore në tërësi, ose në lidhje me secilën çështje të shtruar për vlerësim apo kërkesë të objektit të padisë, gjyqtarja konkludon lidhur me çështjen, duke e paraqitur këtë pjesë, si sintezë të analizës ligjore të kryer.

Në pjesën e dispozitivit, gjen pasqyrim disponimi i gjykatës në lidhje me pranimin/ rrëzimin e padisë, përcaktimin e detyrimeve të palës së paditur, në rastet kur padia është pranuar tërësisht ose pjesërisht, përcaktimi i cilësisë së vendimit si titull ekzekutiv, disponimin për shpenzimet gjyqësore dhe të drejtën e ankimit. Në vendimet civile që përmbajnë detyrime, gjyqtarja ka nxjerrë vendim për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit në referim të parashikimeve të nenit 511/1⁴⁰ të K.Pr.Civile.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi mbi mesatare në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të organizuar të vendimit. Gjyqtarja ndjek përgjithësisht një strukturë sipas këtij rendi: parashtrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e palëve, analizimin e fakteve dhe të provave të paraqitura, duke e integruar me ligjin e zbatueshëm që duhet të shqyrtohen nga gjykata në lidhje me themelin, duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese ose të çdo pjesë të veçantë të tij, përfundimet e arritura nga gjykata, ndërsa në disa vendime strukturimi nuk bëhet sipas këtij rendi logjik. Përgjithësisht konstatohet se gjyqtarja strukturon qartë mendimin dhe argumentimin logjik, në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit. Por nuk konstatohet e njëjta aftësi në përshkrimin dhe analizën e fakteve procedurale dhe në paraqitjen e ecurisë procedurale të çështjes, e cila në disa raste është e nevojshme dhe as në përshkrimin dhe analizën e fakteve thelbësore të çështjes.

⁴⁰Në nenin 511/1 të K.Pr.Civile, para ndryshimeve me ligjet nr. nr. 114/2016, datë 3.11.2016; nr. 38/2017, 30.3.2017, parashikohet se: “Për rastet e parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b” të nenit 510 të këtij Kodi, urdhri i ekzekutimit lëshohet së bashku me vendimin gjyqësor dhe bëhet i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor vetëm pas konfirmimit nga kancelari. Kancelari konfirmon urdhrin e ekzekutimit vetëm pasi verifikon se vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “Mbi mesatare” dhe pikëzohet me 8 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ-ja është shprehur se, megjithëse gjykatave u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t’u ankuar.⁴¹

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe vendimet e administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se; *“Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Vendimet e ndërjetme gjithashtu, shoqërohen me referencë ligjore dhe kur duhet jepen arsye për dhënien e tyre....”*

Referuar vendimeve gjyqësore burim vlerësimi, evidentohet se në tërësi, në të gjitha aktet e analizuar rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale. Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një organizim dhe një zhvillim logjik të

⁴¹ Vendimi i GJEDNJ, çështja Hadjanastassiou vs Greqisë, dt. 16.12.1992, fq. 33.

koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material civil, duke u kujdesur, për të identifikuar dhe analizuar koncepte ligjore specifike, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se vendimet gjyqësore dominohen nga procesi analitik dhe vlerësues të fakteve dhe provave në raport me njëra –tjetrën si dhe ligjin e zbatueshëm. Gjyqtarja, përgjithësisht përshkruan dhe analizon në mënyrë të qartë faktet e çështjes tek pjesa e analizës ligjore mbi faktet e çështjes, duke integruar në këtë analizë pjesë të provave ose faktet që rezultojnë prej tyre, çka e bën të qartë dhe të kuptueshme analizën e faktit dhe orienton me tej argumentimin logjik lidhur me pretendimet e palëve, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Në vendimet gjyqësor, konkluzioni arrihet pas arsyetimit dhe argumentimit ligjor.

Në arsyetimin e vendimeve, në analizën e përdorur në arritjen e konkluzionit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes civile, gjyqtarja i kushton rëndësi evidentimit të marrëdhënies shkak – pasojë në marrëdhëniet juridike civile.

Arsyetimi i vendimeve përgjithësisht është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse (që në disa raste shkon edhe në përsëritje të argumentave), për të konkluduar për bazueshmërinë ose jo të këtyre pretendimeve, në raport me faktet e provuara në gjykim dhe parashikimet e ligjit në raport me to. Në vendimet e analizuara, pretendimet e palëve janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, në të cilën paraqiten në mënyrë të hollësishme në disa vendime në fillim të pjesës përshkrueses- arsyetuese dhe në disa raste pas rrethanave të çështjes. Analiza e këtyre pretendimeve, me natyrë procedurale, apo me bazueshmërinë e çështjes në themel, bëhet në pjesën e arsyetimit ligjor të vendimit, duke u pozicionuar dhe analizuar në pjesën e duhur të arsyetimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret, duke marrë gjithmonë përgjigje të argumentuar në drejtim të mbështetjes në ligj ose prova të tyre.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke marrë si një e tërë, pa i dhënë peshë secilit prej tyre, rezulton gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Argumentimi për çdo konkluzion të arritur mbi çështjet e analizuara, si në aspektin procedural ashtu edhe në lidhje me themelin, ka në bazë një analizë të detajuar dhe të integruar të provave, interpretim të ligjit të zbatueshëm dhe aplikimin e tij mbi faktin konkret, duke evidentuar qartë marrëdhënien shkak-pasojë dhe mënyrën e zbatimit të dispozitave ligjore mbi një situatë të caktuar. Arsyetimi i vendimeve përgjithësisht është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse, duke përmbushur standardet e procesit të rregullt ligjor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
90	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSIA ORGANIZATIVE E GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtarja përdor kohën e tij, si kur gjykon i vetëm, ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe vendimet e administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja {...} Vlora ({...}) ka qënë në intervale kohore nga 1 ditë (shih dosjen nr.4 masë sigurimi) deri në 9 muaj e 3 ditë (shih dosjen nr.2)...”.

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar vetëm 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, pa përfshirë 3 (tre) vendimet e zgjedhura nga gjyqtarja në kushtet kur në ekstremitetet e këtyre vendimeve nuk ka të dhëna lidhur me datën e regjistrimit të çështjes.

Nga vëzhgimi i 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se vetëm për 1 (një) prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e gjykimit.

Konkretisht: Çështja e kategorisë “Kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake” (*vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit*), për të cilën është parashikuar si afat ligjor për përfundimin, afati 48 orë nga momenti i regjistrimit të kërkesës në gjykatë. Referuar vendimit nr. 58 akti, datë 11.01.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se kërkesa për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës ka si datë regjistrimi datën 10.01.2016 dhe datë vendimi datën 11.01.2016. Rezulton që është respektuar afati 48 orë i parashikuar në nenin 259/5 të K.Pr.Penale për përfundimin e saj.

Ndërkohë nga vëzhgimi i dosjeve që i përkasin vendimeve burim vlerësimi, rezulton se në dosjen nr. 3, që i përket çështjes civile nr. 8185 regjistri, datë regjistrimi 03.12.2012, me palë paditëse shoqëria “. D. Topi, etj”, i paditur ZVRPP, F.Topi, etj, me objekt të padisë “*Kërkim i pasurisë trashëgimore...*”, përfunduar me vendimin nr.10349, datë 18.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjyqtarja ka shqyrtuar kërkesën për marrjen e masës së sigurimit të padisë, kërkesë që është paraqitur në datë 05.09.2012 dhe është shqyrtuar në seancën gjyqësore të datës 10.09.2012, ku gjyqtarja pasi e ka shqyrtuar ka vendosur rrëzimin e saj. Gjithashtu, rezulton se një kërkesë e tillë është përsëritur nga pala paditëse në datë 16.01.2013 (sipas datës që mban kërkesa e ndodhur në dosje), por shqyrtimin e saj pala paditëse e ka lënë pasi të rregullohej ndërgjyqësia. Kalimi procedural është bërë në seancën e datës 25.06.2013, dhe pasi janë njoftuar palët për seancën e datës 22.07.2013 pala paditëse ka kërkuar që kërkesa për sigurimin e padisë të merrej në shqyrtim në këtë seancë. pasi gjykata e ka marrë në shqyrtim ka vendosur pranimin e saj. Pra konstatohet se në këtë rast gjyqtarja ka respektuar afatin 5 ditor të shqyrtimit të kësaj kërkesë konform nenit 202 të K.Pr.Civile.

Ndërkohë në dosjen me nr.8 (3) që i përket çështjes civile me nr. 4500 regjistri, datë regjistrimi 12.01.2015 me palë paditëse Sh.Ago, palë e paditur Shoqëria “OSHEE” sh., me objekt “*Pavlefshmëri titulli ekzekutiv. Marrje masës së sigurimit , pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv...*”, e përfunduar me vendimin nr. 6751, datë 17.09.2015, të Gjykatës së

Rrethit Gjyqësor Tiranë, dosje e cila i është shortuar gjyqtarës në datë 14.01.2015, gjyqtarja ka shqyrtuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv në seancën përgatitore të datës 29.01.2015, duke vendosur në përfundim refuzimin e kësaj kërkesë (me aq sa lexohet procesverbali, duke e shqyrtuar kështu, rreth për 15 ditë nga momenti i caktimit, jashtë afatit 5 ditor të parashikuar në nenin 609, pg 3 të KPRC⁴². Nga aktet e ndodhura në dosje konstatohet gjithashtu, se gjyqtarja e ka vënë në lëvizje këtë dosje në datë 20.01.2015, pra rreth 6 ditë pas caktimit të saj, duke qenë që në këtë moment jashtë afatit 5 ditorë dhe më pas e ka caktuar seancën në datë 29.01.2015, pra pas 9 ditëve, përsëri jashtë afatit 5 ditorë.

Gjithashtu, në dosjen me nr.9 (4) që i përket çështjes civile me nr.3798 akti, datë 05.12.2015, shortuar gjyqtarës në datë 09.12.2014, me palë paditëse G. V dhe palë e paditur UKT, me objekt *“Pavlefshmëri titulli ekzekutiv.... peullim i ekzekutimit të këtyre faturave”*, përfunduar me vendimin nr.4009, datë 15.05.2015, gjyqtarja ka vënë në lëvizje këtë çështje në datë 11.12.2014 (sipas shënimit të ndodhur në dosje), duke caktuar seancën e parë përgatitore në datën 22.12.2014, pra rreth 13 ditë pas shortit, apo 11 ditë pasi ajo ka urdhëruar caktimin e seancës së parë përgatitore. Procesverbali i seancës përgatitore është tepër i vështirë të lexohet, duke mos u kuptuar nëse në këtë seancë është marrë në shqyrtim kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv dhe çfarë ka vendosur gjykata. Në dosje nuk ndodhet ndonjë vendim i arsyetuar dhe kjo ecuri procedurale nuk është përshkruar as në vendimin përfundimtar. Por duke qenë se kjo kërkesë nuk është përsëritur më në seancë gjyqësor, mund të prezumohet se është marrë në shqyrtim në seancën e parë përgatitore, duke u shqyrtuar kështu jashtë afatit 5 ditorë të parashikuar nga neni 609 paragrafi i tretë i K.Pr.Civile.

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjeve të analizuara më sipër në të cilat për 1 (një) prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre dhe kjo çështje ka përfunduar brenda afatit ligjor (48 orë sipas nenit 259 të K.Pr.Penale), rezulton se raporti i çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor në raport me numrin e përgjithshëm të çështjeve për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është 0 %. Por duke iu referuar çështjeve të tjera burim vlerësimi të analizuara më sipër, megjithëse janë çështje për të cilat ligji nuk ka parashikuar afat gjykimi, gjatë shqyrtimit të tyre janë paraqitur dhe marrë në shqyrtim kërkesa për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (sigurim padie dhe pezullim i ekzekutimi të titullit ekzekutiv), nga të cilat rezultoi se për një çështje gjyqtarja ka respektuar afatin 5 ditorë të shqyrtimit dhe për dy çështje të tjera ky afat nuk është respektuar, duke e tejkaluar këtë afat me mbi 10 ditë. Ky tejkalim ka ndodhur për shkak të caktimit të seancës së parë përgatitore jashtë afatit 5 ditorë nga paraqitja e kërkesës, duke qenë kështu që në fillim në tejkalim të këtij

⁴² Neni 609 paragrafi i 3 i KPRC, në fuqi, parashikonte se:” Gjykata shqyrton kërkesat, sipas këtij neni, brenda 5 ditëve. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë”.

afati. Kështu, duke marrë në konsideratë edhe këto çështje rezulton se raporti i çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit është me rreth 50 %, pasi dy çështje kërkesa janë shqyrtuar brenda afatit ligjor dhe dy kërkesa të tjera jashtë këtij afati.

Referuar tabelws së pikëzimit për këtë tregues, të përcaktuar në rregulloren nr.264/2019 “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, kjo përqindje ekuivalentohen me 3 pikë (Mbi 40%- 3 pikë).

Në metodologjinë e pikëzimit, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjithave burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Për sa i përket dy dosjeve të sipërcituara, në të cilat së bashku me padinë është paraqitur dhe kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv rezulton se gjyqtarja që në fillim nuk ka marrë asnjë masë për shqyrtimin e tyre brenda afatit 5 ditorë të parashikuar nga neni 609 paragrafi i 3 i K.Pr.Civile, në kushtet kur seanca e parë përgatitore është caktuar jashtë këtij afati, duke u caktuar seanca në një rast pas 13 ditëve dhe në një rast pas 15 ditëve nga caktimi i tyre. Ndërsa në dosjen me objekt vleftësim arresti caktim mase sigurimi personal, si dhe në dosjen ku është paraqitur kërkesa me objekt sigurim padie, afati ligjor i shqyrtimit të tyre është respektuar nga gjykata.

Në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton se gjyqtarja ka përfunduar në total për gjithë periudhën 3-vjeçare objekt vlerësimi (08.10.2013-08.10.2016) 1470 çështje, nga të cilat 602 çështje themeli dhe 868 kërkesa, nga të cilat 343 çështje janë masa sigurim personal, mesatarisht 200 çështje themeli në vit, ndërkohë që duhej të shqyrtonte jo më pak se 120 çështje themeli në vit, referuar vendimit 261/2 të ish KLD-së⁴³, duke tejkaluar këtë standard me 67% .

Duke konsideruar natyrën e kërkesave të shqyrtuara tej afatit ligjor, të cilat janë të lehta, si dhe duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vendimi me objekt vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi personal, që nga ana e gjyqtares është respektuar afati ligjor i shqyrtimit, prezumimin se edhe për 343 çështje të tjera që i përkasin kësaj kategorie “masa sigurim personal”, gjyqtarja ka respektuar gjithmonë afatin ligjor të shqyrtimit të tyre, por edhe të kërkesave të tjera me objekt sigurim padie që mund të jenë paraqitur gjatë gjykimeve, vlerësohet se gjyqtarja merr masa për shqyrtimin e çështjeve brenda afateve ligjore.

⁴³Lidhur me standardin sasior të punës, në vendimin nr. 261/2, viti 2010 të KLD-së parashikohet standardi sasior si më poshtë: *e. Gjyqtari i shkallës së parë i dhomës civile, si relator, i seksionit të përgjithshëm, jo me pak se 120 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare*

KONKLUZIONE

Në tërësi, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve dhe kërkesave të gjykuara në tejkalim të afatit ligjor, që rezultojnë në masën 50 %; (ii) faktin se dy kërkesat që janë shqyrtuar tej afatit ligjor prej 5 ditëve i përkasin fazës së ekzekutimit dhe janë paraqitur së bashku me padinë (iii) ngarkesën e gjyqtarës si relatore gjatë periudhës së vlerësimit (në total ka gjykuar 1470 çështje, duke gjykuar mesatarisht 490 çështje në vit, nga të cilat rreth 200 çështje janë me palë kundërshtare dhe gjatë kësaj periudhe së paku janë shqyrtuar 343 çështje (masa sigurim) të cilat janë me afat ligjor), gjyqtarja për këte tregues duhet të vlerësohen me një nivele të ndryshëm se pikëzimi që rezulton nga të dhënat statistikore, duke u pikëzuar me 12 pikë, por kurrësi nuk duhet të shkojë në një pikëzim maksimal, pasi nuk rezulton se gjithmonë ka marrë masa për shqyrtimin e kërkesave për të cili ligji ka parashikuar afat ligjor, brenda këtyre afateve.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore”, gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet 12 pikë, duke e vlerësuar se përqindja e çështjeve të gjykuara prej saj tej afatit ligjor është 11-20 %.*

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe vendimet e administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Në 5 dosje të vëzhguara, është konstatuar se në katër raste, është shkelur afati ligjor ose afati standard i gjykimit (shih dosjet 1, 2, 3 dhe 4). Në tre dosjet me nr. 1, 2 e 3, ku është tejkaluar afati standard i gjykimit, është konstatuar se përveç sjelljes së palëve në mosrespektimin e afatit

standart, ka ndikuar edhe organizimi e planifikimi i punës nga ana e gjyqtarës (më hollësisht shih analizën e dosjeve 1, 2 e 3). Në dosjen nr. 4, afati standard është tejkaluar, por nuk kemi ndeshur probleme në organizimin dhe planifikimin e punës nga ana e gjyqtarës Vlora (më hollësisht shih analizën e dosjes 4)... “.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 10⁴⁴ çështjeve të përzgjedhura me short, pa përfshirë tre vendimet e zgjedhura nga gjyqtarja, në kushtet kur në ekstremitetet e vendimit nuk ka të dhëna lidhur me datën e regjistrimit të çështjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se për të gjitha çështjet e vëzhguara, gjykimi jo gjithmonë ka përfunduar brenda standardit minimal kohor sipas vendimit nr.261/2 të ish KLD-së.⁴⁵

Referuar 10 (dhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short,⁴⁶ konstatohet se:

- (i) Çështja civile nr. 13900/2239 regjistri, datë 19.09.2014 regjistrimi që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës A. M kundër palës së paditurit Shoqëria CEZ sh.a, me objekt të padisë *“Detyrimin e të paditurit të më shpërblejë pagën e një viti punë...”*, e përfunduar me vendimin nr. 4358, datë 27.05.2015, rezulton se ka përfunduar për një afati prej 8 muaj e 8 ditë, **jashtë standardit minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.**
- (ii) Çështja civile nr. 18912/5904 regjistri, datë 30.10.2013 regjistri që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës A. B. kundër të paditurit Sh. Sh., me objekt të padisë *“Konstatimin e pavlefshmërisë së testamentit nr.1 rep,dhe nr. kol nuk ka, datë 05.05.2000...”*, e përfunduar me vendimin nr. 10342, datë 28.10.2014, rezulton se ka përfunduar brenda një afati prej 11 muaj e 28 ditë, **jashtë standardit minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.**
- (iii) Çështja civile nr.8185/1960 regjistri, datë 03.02.2012, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës D.T, L.Ç etj. kundër të paditurve ZVRPP Tianë, F. T, Q. Gj etj.,me objekt të padisë *“Kërkimin e një pjese të pasurisë trashëgimore...”*, përfunduar me vendimin nr.10349, datë 18.10.2013, rezulton se ka përfunduar në një afat prej 1 vit e 8 muaj e 15 ditë, **jashtë standardit minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.** Po të zbrisim nga ky afat, muajin gusht të vitit 2012 dhe 2013 gjatë secilit gjyqtarët dhe administrata kryejnë lejen e zakonshme, rezulton se çështja ka përfunduar për një afat prej 1 vit, 6 muaj e 15 ditë, përsëri jashtë standardit minimal kohor.

⁴⁴Nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykim

⁴⁵Sipas vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: *“Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si me poshtë: b. Gjykimet e mosmarrëveshje tregtare në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 6 muaj... e. Gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm, jo më tej se 6 muaj... j. Gjykimi i çështjeve të karakterit administrativo-penal dhe i çështjeve civile pa palë kundërshtare në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 2 muaj.”.*

⁴⁶Sikundër kemi analizuar nga 11 çështje të përzgjedhura me short, 1 prej tyre parashikon afat ligjor dhe 10 afat standard minimal kohor për përfundimin e tyre.

- (iv) Çështja civile nr.11160 regjistri, datë 20.03.2013, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës H.Gj., kundër të paditurit F.A, palë e tretë BKT, me objekt të padisë “Pjestim i pasurisë bashkëshortore”, përfunduar me vendimin nr.11213, datë 11.11.2013, rezulton se ka përfunduar në një afat prej 7 muaj e 21 ditë, **jashtë standard minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.** Po të zbresim nga ky afat, muajin gusht gjatë secilit gjyqtarët dhe administrata kryejnë lejen e zakonshme, rezulton se çështja ka përfunduar për një afat prej 6 muaj e 21 ditë, duke e tejkualuar afatin standard minimal me 21 ditë.
- (v) Çështja civile nr.9600 regjistri, datë 28.03.2014, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës M. Xh., kundër të paditurit Drejtoria e Përgjithshme e Postës, me objekt të padisë “Kundërshtim vendim. Detyrim për shpërblim page për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës...”, përfunduar me vendimin nr. 8615, datë 08.09.2014, rezulton se ka përfunduar në një afat prej 5 muaj e 11 ditë, **brenda standardit minimal kohor prej 6 (gjahtë) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.**
- (vi) Çështja civile me nr.9006 regjistri, datë 30.01.2013, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës S.Xh., kundër të paditurit Këshilli i Qarkut Tiranë, me objekt të padisë “Njohje e vërtetësisë së dokumentit “Vërtetim kadastral”...”, përfunduar me vendimin nr.10757, datë 30.10.2013, rezulton se ka përfunduar në një afat prej 9 muaj, **jashtë standardit minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.**
- (vii) Çështja civile me nr. 3798 regjistri, datë 05.12.2014, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës G.V., kundër të paditurit UKT sh.a., etj., me objekt të padisë “Pavlefshmëri e titullit ekzekutiv fatura e shitjes së ujit të pijshëm...”, përfunduar me vendimin nr. 4009, datë 15.05.2015, rezulton se ka përfunduar në një afat prej 5 muaj e 10 ditë, **brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.**
- (viii) Çështja civile me nr.4500 regjistri, datë 12.01.2015, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës Sh. A, kundër të paditurit OSSHE., me objekt të padisë “Marrjen e masës së sigurimit të padisë, pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv...Shpalljen e pavlefshëm të titullit ekzekutiv faturë tatimore e shitjes së energjisë elektrike...”, përfunduar me vendimin nr. 6751, datë 17.09.2015, rezulton se ka përfunduar në një afat prej 8 muaj e 5 ditë, **jashtë standardit minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.**
- (ix) Çështja civile me nr. 3855 regjistri, datë 25.11.2015, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës Shoqëria “Telecom Albania”, kundër të paditurit N. N., me objekt të padisë “Përmbushje e detyrimit kontraktor...”, përfunduar me vendimin nr.5209, datë 16.06.2016, rezulton se ka përfunduar në një afat prej 6 muaj e 21 ditë, **jashtë standardit minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD, duke e tejkualuar këtë afat me 21 ditë.**
- (x) Çështja civile me nr.256 regjistri, datë 03.10.2013, që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës A.Xh, kundër të paditurit Shoqëria Arkensi., me objekt të padisë “Dëmshpërblim që rrjedh nga aksidenti në punë...”, përfunduar me vendimin nr.3198, datë 18.04.2016, rezulton se ka përfunduar në një afat prej 1 vit, 9 muaj, e 14 ditë (papërfshirë këtu periudhën në të cilën gjyqtarja ka qenë me leje të zakonshme gjatë vitit 2014 si dhe periudhën e pezullimit të çështjes, nga data 04-05.2015-02.12.2015). Përsëri ka përfunduar, **jashtë standardit minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.**

Përlllogaritjeve të afatave sa më sipër, nuk i është zbritur muaji gusht në të cilin gjyqtarët kryejnë lejen vjetore. Gjithsesi, në zbresim muajin gusht në përlllogaritjet e mësipërme, rezultati nuk ndryshon, çështjet e gjykuara jashtë standartit minimal kohor mbeten sërish jashtë këtë afati minimal kohor.

Nga 10 çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, sikundër rezultoi edhe më sipër, rezultoi se vetëm 2 çështje kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor, sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së dhe 8 (tetë) prej tyre kanë përfunduar jashtë afatit standard minimal kohor të përcaktuar për secilën kategori. Pra, në total 80% të çështjeve janë jashtë afatit standard minimal kohor. Referuar metodologjisë së pikëzimit, përqindja matematikore prej 80% përkon me nivelin e vlerësimit 1 (një) pikë.

Megjithatë, në rast se do të bëjmë një analizë të kohëzgjatjes së çështjeve, duke zbritur këtu kohën gjatë secilës gjyqtarët kryejnë lejen e zakonshme, si dhe festat e fundvitit, rezultojnë se edhe 3 çështje të tjera mund të konsiderohen të përfunduara brenda standardit minimal kohorë, konkretisht;

1. Çështja me nr. 3855 regjistri, datë 25.11.2015, përfunduar me vendimin nr.5209, datë 16.06.2016, ka përfunduar në një afat prej 6 muaj e 21 ditë. Nëse do të llogarisim këtu festat e fundvitit dhe mbartjes së dosjeve, tejkalimi i afatit është thujse i pallogaritshëm dhe çështja do të konsiderohet e gjykuar brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.
2. Çështja civile me nr.4500 regjistri, datë 12.01.2015, përfunduar me vendimin nr. 6751, datë 17.09.2015, ka përfunduar në një afat prej 8 muaj e 5 ditë. Nëse në përlllogaritje do të zbresim lejen vjetore të muajit gusht, rezulton që çështja të jetë gjykuar për rreth 7 muaj. Për shkak se tejkalimi i afatit nuk është shumë i madh dhe çështja në dukje e thjeshtë ka pasur kompleksitetin e saj, çështja do të konsiderohet e gjykuar brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.
3. Çështja civile nr.11160 regjistri, datë 20.03.2013, përfunduar me vendimin nr.11213, datë 11.11.2013, ka përfunduar në një afat prej 7 muaj e 21 ditë. Nëse në përlllogaritje do të zbresim lejen vjetore të muajit gusht, rezulton që çështja të jetë gjykuar për 6 muaj e 21 ditë, me një tejkalim të papaërfillshëm të afatit dhe për këtë arsye çështja do të konsiderohet brenda standard minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.

Kështu, nga kjo rilllogaritje, rezulton se nga 10 çështje për të cilat përcaktohen standardet minimale kohore të shqyrtimit të tyre, 5 prej tyre janë shqyrtuar jashtë standardit minimal kohor, apo 50 % e tyre, përqindje matematikore e cila gjithashtu pikëzohet me 1 pikë (Mbi 40 %- 1 pikë)

Në Metodologjia e pikëzimit me përcaktohet se veç analizës matematikore, vlerësuesi duhet të kryejë edhe një analizë logjike të të dhënave, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Pavarësisht se për 50 % të çështjeve të shqyrtuara (burime vlerësimi), rezulton tejkalim i standardit minimal kohor të pranuar prej 6 muaj, rezulton se ka qenë përgjithësisht pasojë e ecurisë procedurale të çështjes, në disa raste për shkak të mosformimit të trupit gjykues (mosparaqitjes së gjyqtarës për arsye të përlligjura), mungesës së palëve ndërgjyqëse, kërkesës së palëve për të paraqitur prova, marrjen e provës me ekspert, si dhe kërkesave të vazhdueshme procedurale të palëve.

Nga ana tjetër në aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton se gjyqtarja gjatë periudhës 3 vjeçare të vlerësimit ka përfunduar në total 1470 çështje, nga të

cilat 602 çështje themeli dhe 868 kërkesa, mesatarisht 200 çështje themeli në vit, ndërkohë që duhej të shqyrtonte jo më pak se 120 çështje themeli në vit, referuar vendimit 261/2 të ish KLD-së⁴⁷, duke tejkuluar këtë standard me 67%.

KONKLuzioni

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me:

- (i) raportin e çështjeve të gjykuara jashtë standardit minimal kohor me numrin total të çështjeve të analizuar si më sipër cituar (2 nga 10 çështje), që rezulton në masën 80%, përqindje e cila po të zbresim edhe tre çështje për të cilat afati është tejkuluar më disa ditë rezulton 50 %;
- (ii) faktorët që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit të cilat, nga dosjet e vëzhguara, përgjithësisht nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarës, por që lidhen me ecurinë e procesit gjyqësor, respektimin e të drejtave të palëve, njoftimin e tyre etj.;
- (iii) treguesin sasior të punës gjatë periudhës së vlerësimit gjatë së cilët gjyqtarja ka përfunduar 1470 nga të cilat 602 çështje themeli, duke e tejkuluar standardin minimal sasior (jo më pak se 360 çështje për 3 vjet), me më shumë se 67%, në raport me standardi minimal sasior i punës sipas “Kritereve matëse të veprimtarisë gjyqësore” miratuar me vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së;
- (iv) natyrën orientuese dhe jo detyruese të këtyre standardeve kohore, ku hapësira e vlerësimit është me e gjerë se treguesi i “respektimit të afateve ligjore”;

pavarësisht përqindjes së mësipërme, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me 3 nivele me shumë se sa ai që i përket analizës matematikore, duke u pikëzuar me 4 pikë. Ky vlerësim bazohet në parimin e parashikuar nga neni 93 pika 2 e Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në R.Shqipërisë”, të ndryshuar, sipas të cilit aftësia e gjyqtarit lidhur me kohëzgjatjen e gjykimeve duhet të analizohet sipas situatës, duke shmangur përfundime për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Aftësia e gjyqtarit për respektimin e standardit minimal, nuk mund të barazohet vetëm me treguesin e shifrës apo të dhënës statistikore, pasi në rastin konkret ka qenë e mundur të analizohet çdo dosje gjyqësore, ku çështja ka përfunduar tej standardit minimal, analizë nga ka rezultuar që zgjatja ka ardhur për shkak kompleksiteti, sjellje të palëve, respektimit të të drejtave procedurale të palëve dhe nevojës për hetim gjyqësor të plotë e gjithëpërfshirës.

⁴⁷Lidhur me standardin sasior të punës, në vendimin nr. 261/2, viti 2010 të KLD-së parashikohet standardi sasior si më poshtë: *e. Gjyqtari i shkallës së parë i dhomës civile, si relator, i seksionit të përgjithshëm, jo me pak se 120 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare*

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 4 pikë, pasi shqyrtimi i çështjeve jashtë standardit minimal, përgjithësisht ka ardhur për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës.

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJEJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe vendimet e administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar nuk ka të dhëna apo konkluzione lidhur me këtë tregues.

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:***

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve që trajtohen në gjykatat e Shkallës së Parë në periudhën e vlerësimit. Për pasojë, vlerësimi edhe për këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 10 (dhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit.

Nga burimet e vlerësimit rezulton se të gjitha çështjet i përkasin kategorisë civile themeli. Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 10 çështjet në kategorinë e çështjeve “civile themeli”, rezulton të jetë rreth 296.2 ditë, ose 9 muaj e 26 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor prej 6 muaj për gjykimin e çështjeve civile të themelit në Gjykatën e Shkallës së Parë. Në përlllogaritjen e kohës mesatare të gjykimit të secilës çështje është zbritur koha që një çështje ka qenë e pezulluar si dhe periudha e kryerjes së lejes së zakonshme për të gjitha çështjet e tjera.

KONKLUZIONI

Referuar analizës matematikore si më sipër, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e gjatë se standardi minimal kohor për kategorinë e vetme të çështjeve të gjykuara, civile me palë kundërshtare, pra 100 %. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit kjo llogaritje matematikore përkon me një pikëzim prej 1 pikësh. Mbështetur në të njëjtën analizë si treguesi më sipër (*treguesi “2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore”*), konkretisht duke marrë në konsideratë shkaqet e shtyrjes dhe të zgjatjeve të gjykimeve, të cilat kanë qenë kryesisht për shkaqe procedurale, mungesës së gjyqtareve për arsye të përligjura (raport shëndetësore) por edhe të mungesës së njoftimeve të palëve, komplekstetit të çështjeve, ngarkesën e gjyqtareve gjatë periudhës së vlerësimit, faktin se ajo e ka tejkaluar standardin minimal me 67 %, vlerësoj që niveli i vlerësimit duhet të jetë më i lartë se ai që i korespondon pikëzimit të përcaktuar në tabelën përkatëse, duke e ngritur deri me tre nivele vlerësimi, por gjithësesi nuk justifikohet një pikëzimin maksimal. Gjithashtu, në përcaktimin e këtij vlerësimi, duhet të merren në konsideratë edhe faktin se të 10 çështjet burim vlerësimi i përkasin kategorisë së çështjeve civile me palë kundërshtare, si dhe mungesën e të dhënave për kohëzgjatjen mesatare të gjykimit për kategoritë e tjera të çështjeve të gjykuara nga gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtareve dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 4 pikë, duke e konsideruar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve.*

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me rendimentin e përfundimit të çështjeve konkludohet se: “...Subjekti rivlerësimit {...} Viora në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ajo ka deklaruar në formularin e vetvlerësimit se gjatë periudhës 08.10.2013-08.10.2016, i janë caktuar për gjykim gjithsej 2520 çështje, ku ka përfunduar 1972 çështje, duke

mbartur vitin e fundit 157 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve bazuar në këto të dhëna është 78.2%.”.

- Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar të dhënave të pasqyruara në tabelën e të dhënave statistikore, bashkëlidhur Formularit të vetëvlerësimit,⁴⁸ shënohen të dhënat statistikore të ndara sipas viteve kalendarike dhe konkretisht:

- Në vitin e plotë 2013, i janë caktuar si çështje të reja 668 çështje, ka përfunduar 489 çështje, duke mbartur për vitin pasardhës 179 çështje;
- Në vitin e plotë 2014, i janë caktuar si çështje të reja⁴⁹ 649 çështje, ka përfunduar 546 çështje, duke mbartur për vitin pasardhës 103 çështje;
- Në vitin e plotë 2015, i janë caktuar 582 çështje, ka përfunduar 473 çështje, duke mbartur për vitin pasardhës 109 çështje;
- Në vitin e plotë 2016, i janë caktuar 621 çështje, ka përfunduar 464, duke mbartur për vitin pasardhës 157 çështje.

Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabela me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së 08.10.2013-08.20.2016, duke u bazuar në të dhënat statistikore bashkëlidhur formularit të vetëvlerësimit për periudhën e plotë 2013-2016, e cila në këtë rast konsiderohet periudhë e plotë vlerësimi, rendimenti duhet të përcaktohet referuar raportit të çështjeve të përfunduara 1972 çështje, me çështjet e caktuara 2520 çështje gjatë periudhës së vlerësimit, **në masën 78.2%, aq sa është llogaritur edhe nga raporti i KLGJ**, përqindje e cila referuar Metodologjisë së Pikëzimit, pikëzohet me 2 pikë (Nwn 81 %- 2 pikë).

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: *“Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.”*

Referuar pikës 3, shkronja “e” të vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD (Aneksit 1), gjyqtari i dhomës civile të seksionit të përgjithshëm duhet të gjykojë jo më pak se 120 çështje me palë kundërshtare në një vit, i llogaritur në periudhën 3 vjeçare jo me pak se 360 çështje civile.

⁴⁸Faqe 47-48 të dosjes së rivlerësimit

⁴⁹ “Çështje te reja” janë ato që janë regjistruar të reja brenda një viti kalendarik, duke hequr çështjet e mbartura nga vitet paraardhëse.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për efekte të organizimit të shortit për përzgjedhje e çështjeve për vlerësim, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016, gjyqtarja {...} Vlora ({...}) ka përfunduar 1470 çështje, nga të cilat 600 çështje civile të përgjithshme + çështje tregtare, 2 çështje penale, 3 kërkesa penale, 343 kërkesa penale në fazën e hetimit (masa sigurimi) dhe 522 kërkesa civile.

Referuar tabelave statistikore për periudhën 08.10.2013-08.10.2016 rezultojnë të dhënat e mëposhtme për kategori çështjesh të gjykuara për çdo vit kalendarik:

- (i) Viti 2013 (3 muaj): gjithsej 122 çështje, nga të cilat 76 civile të përgjithshme – ose 153% më shumë se standardin minimal sasior i e miratuar, duke llogaritur periudhën 3 mujore;
- (ii) Viti 2014: gjithsej 539 çështje nga të cilat 221 çështje me palë kundërshtare (*civile të përgjithshme, tregtare dhe penale*), ose 84% më shumë se standardi minimal sasior i miratuar;
- (iii) Viti 2015: gjithsej 477 çështje, nga të cilat 172 çështje me palë kundërshtare (*civile të përgjithshme dhe penale*), ose 43% më shumë se standardi minimal sasior i miratuar;
- (iv) Viti 2016 (9 muaj): gjithsej 329 çështje nga të cilat 133 çështje me palë kundërshtare (civile të përgjithshme dhe tregtare) – ose 47% më shumë se standardi minimal sasior i miratuar, duke llogaritur periudhën 9 mujore.

Pra në lidhje me aspektin sasior rezultoi se gjatë periudhës 3 vjeçare të vlerësimit 08.10.2013-08.10.2016, gjyqtarja ka gjykuar 602 çështje me palë kundërshtare, nga 360 çështje që është standardi minimal sasior i miratuar, duke e tejkaluar këtë standard me 67%.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, megjithëse rendimenti i gjyqtarës për periudhën e vlerësimit është 78.92 % i përcaktuar në Raportin KLGJ-së, përqindje e cila referuar metodologjisë së Pikëzimit pikëzohet me 2 pikë, duke marrë në analizë të dhënat e tjera që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me; (i) ngarkesën e gjyqtarës si relatores (*në total ka gjykuar 1470 çështje, nga të cilat 602 çështje me palë kundërshtare, 3 kërkesa penale, 343 kërkesa penale në fazën e hetimit “masa sigurimi” dhe 522 kërkesa civile*), pra mesatarisht rreth 490 çështje në vit, duke e tejkaluar kështu standardin minimal sasior sa i takon çështjeve me palë kundërshtare të gjykuara me 67 %, (ii) numrin e lartë të çështjeve të reja të regjistruara gjatë periudhës së plotë 2013-2016 (2520 çështje) të vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivel të ndryshëm pikëzimi, duke e rritur me tre nivele, pra me 8 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 8 pikë, duke qenë se në çdo vit ajo e ka tejkaluar standartin minimal sasior, mbi 50 %, konkretisht me 67 %.

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në kryesekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se “Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja {...} Vlora, ka respektuar në 4 raste afatet ligjore për dorëzimin e vendimit të arsyetuar dhe në një rast, vendimi i arsyetuar është dorëzuar dy ditë përtej afatit ligjor, por që kjo shkelje nuk vlerësohet domethënëse. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer për 12 ditë nga shpallja (shih dosjen 1), për 6 ditë nga shpallja (shih dosjet 2 e 3), për 9 ditë nga shpallja (shih dosjen 4) dhe për 4 ditë nga shpallja (shih dosjen 5).”.

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10 (dhjetë) ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Në këto kushte në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10/ditor i ankimit ndaj vendimit penal. Sa i përket vendimeve civile, në nenin 308 të K.Pr.Civile,⁵⁰ para ndryshimeve me ligjin nr.38/2017, parashikohej afati 10 ditor për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Për këtë arsye, për çështjet civile afati i dorëzimit të vendimit do të vlerësohet në raport me afatin 10 ditor, por gjithsesi duke konsideruar edhe afatin 15 ditor të ankimit, sipas legjislacionit procedural civil të kohës.

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Sipas informacionit të përpunuar në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, për 5 dosjet e përzgjedhura në kuadër të këtij procesi, rezulton se :

- Dosja 1 (*çështje civile*), që i përket vendimit me nr. 4358, datë 27.05.2015, është dorëzuar në datën 09.06.2015 - (12 ditë), jashtë afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 2 (*çështje civile*), që i përket vendimit me nr. 10342, datë 28.10.2014, është dorëzuar në datën 03.11.2014 - (5 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 3 (*çështje civile*), që i përket vendimit me nr. 10349, datë 18.10.2013, është dorëzuar në datën 24.10.2013 - (6 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 4 (*çështje civile*), që i përket vendimit me nr. 11213, datë 11.11.2013, është dorëzuar në datën 20.11.2013 - (9 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 5 (*kërkesë penale*), që i përket vendimit me nr.58, datë 11.01.2016, është dorëzuar në datën 15.01.2016 - (4 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

Sipas informacionit të dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, së bashku me fletët e regjistrit të dorëzimit të dosjeve, për 6 çështjet e përzgjedhura rishtazi, rezulton se:

⁵⁰Në nenin 308, pg. 2 të K.Pr.Civile, në fuqi në periudhën e rivlerësimit, parashikohej se: “*Në çështje të ndërlikuara, gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se dhjetë ditë ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit, deri në pesë ditë. Arsyetimi i vendimit bëhet nga kryetari i seancës, përveç kur ai ia beson këtë njërit prej anëtarëve të trupit gjykues*”.

- Dosja 6 (*çështje civile*), që i përket vendimit me nr. 8615, datë 08.09.2014, është dorëzuar në datën 15.09.2014 - (7 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 7 (*çështje civile*), që i përket vendimit me nr. 10757, datë 30.10.2013, është dorëzuar në datën 06.11.2013 - (6 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 8 (*çështje civile*), që i përket vendimit me nr. 4009, datë 15.05.2015, është dorëzuar në datën 25.05.2015 - (10 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 9 (*çështje civile*), që i përket vendimit me nr. . 6751, datë 17.09.2015, është dorëzuar në datën 28.09.2015- (11 ditë), jashtë afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 10 (*çështje civile*), që i përket vendimit me nr. 3198, datë 18.04.2016, është dorëzuar në datën 26.04.2016 - (8 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.
- Dosja 11 (*çështje civile*), që i përket vendimit me nr. 5209, datë 16.06.2016, është dorëzuar në datën 22.06.2016- (6 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.

Sa më sipër analizuar si në raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLD-së lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, ashtu edhe nga të dhënat e sipërcituara në lidhje me dosjet e shortuara, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve për çështjet e kategorisë “Kërkesë penale” është 4 ditë, për kategorinë “Civile themeli” 8 ditë, pra brenda afatit 10 ditor të parashikuar nga ligji.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar sa më sipër analizuar si në raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, ashtu edhe nga të dhënat e sipërcituara në lidhje me dosjet e shortuara rezulton se në tërësi koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar është “*Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjithë kategoritë e çështjeve*”.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi kjo kohë është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve të analizuara.*

2.B. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JOPRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se *“.. në 5 çështjet e vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me 1 seancë (shih dosjen 5), me 7 seanca (shih dosjen 4), me 19 seanca (shih dosjen 3), me 11 seanca (shih dosjen 2) dhe me 10 seanca (shih dosjen 1). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar 48 seanca gjyqësore, nga të cilat 26 seanca nuk kanë qenë produktive. Pengesë në 26 seanca gjyqësore joproduktive janë bërë: mungesat e palëve, mungesa e gjyqtarës për shkaqe shëndetësore, njoftimi i palëve me shpallje, shtyrja e seancës për të marrë prova, shtyrja e seancës për t’u njohur palët me provat e njëra-tjetrës, shtyrja e seancave për të siguruar palët praninë e avokatëve, shtyrja e seancave për të kryer suksesim procedural etj....”*.

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :***

Nga 11 (njëmbëdhjetë) çështjet e përzgjedhura për vlerësim, lidhur me numrin e seancave gjyqësore, 10 (dhjetë) prej tyre vlerësohen si çështje me palë kundërshtarë për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës, pasi dosja me nr.5 i takon kategorisë kërkesa penale në fazën e hetimeve paraprake.

Në çështjet e administruara në dosjen e rivlerësimit dhe në ato të përzgjedhura me short konstatohet se:

- i. Çështja civile nr. 13900/2239 regjistri, datë 19.09.2014 regjistrimi ka përfunduar me vendimin nr. 4358, datë 27.05.2015. Për përfundimin e çështjes janë zhvilluar 10 seanca, nga të cilat 4 seanca përgatitore dhe 6 seanca gjyqësore.

- ii. Çështja civile nr. 18912/5904 regjistri, datë 30.10.2013 regjistri ka përfunduar me vendimin nr. 10342, datë 28.10.2014. Për përfundimin e çështjes janë zhvilluar 11 seanca, nga të cilat 1 seancë përgatitore dhe 10 seanca gjyqësore.
- iii. Çështja civile nr.8185/1960 regjistri, datë 03.02.2012, ka përfunduar me vendimin nr.10349, datë 18.10.2013. Për përfundimin e çështjes janë zhvilluar 19 seanca, nga të cilat 7 seanca përgatitore dhe 12 seanca gjyqësore.
- iv. Çështja civile nr.11160 regjistri, datë 20.03.2013, ka përfunduar me vendimin nr.11213, datë 11.11.2013. Për përfundimin e çështjes janë zhvilluar 6 seanca, nga të cilat 4 seanca përgatitore dhe 2 seanca gjyqësore.
- v. Çështja civile nr.9600 regjistri, datë 28.03.2014, ka përfunduar me vendimin nr. 8615, datë 08.09.2014. Për përfundimin e çështjes janë zhvilluar 5 seanca, nga të cilat 1 seancë përgatitore dhe 4 seanca gjyqësore.
- vi. Çështja civile me nr.9006 regjistri, datë 30.01.2013, ka përfunduar me vendimin nr.10757, datë 30.10.2013. Për përfundimin e çështjes janë zhvilluar 8 seanca, nga të cilat 2 seanca përgatitore dhe 6 seanca gjyqësore.
- vii. Çështja civile me nr. 3798 regjistri, datë 05.12.2014, ka përfunduar me vendimin nr. 4009, datë 15.05.2015. Për përfundimin e çështjes janë zhvilluar 8 seanca, nga të cilat 1 seancë përgatitore dhe 7 seanca gjyqësore.
- viii. Çështja civile me nr.4500 regjistri, datë 12.01.2015, ka përfunduar me vendimin nr. 6751, datë 17.09.2015. Për përfundimin e çështjes janë zhvilluar 11 seanca, nga të cilat 6 seanca përgatitore dhe 5 seanca gjyqësore.
- ix. Çështja civile me nr.256 regjistri, datë 03.10.2013, ka përfunduar me vendimin nr.3198, datë 18.04.2016. Për përfundimin e çështjes janë zhvilluar 33 seanca, nga të cilat 5 seanca përgatitore dhe 28 seanca gjyqësore.
- x. Çështja civile me nr. 3855 regjistri, datë 25.11.2015, ka përfunduar me vendimin nr.5209, datë 16.06.2016. Për përfundimin e çështjes janë zhvilluar 6 seanca, nga të cilat 5 seanca përgatitore dhe 1 seancë gjyqësore.

Çështja e kategorisë “Kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake” (*vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit*), është regjistruar me datë 10.01.2016 dhe ka përfunduar me vendimin nr. 58 akti, datë 11.01.2016. Për përfundimin e çështjes është zhvilluar vetëm 1 seancë gjyqësore.

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në 10 (dhjetë) çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare varion nga 1 deri në 28 seanca gjyqësore. Gjyqtarja ka zhvilluar në total 81 seanca gjyqësore për përfundimin e 10 çështjeve. **Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 8.1 seanca gjyqësore.**

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, duke iu referuar akteve të dosjeve të përzgjedhura me short, rezulton se:

- Gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e

njoftimeve për palët në dosje dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë.

- Në çështjet në të cilat seancat gjyqësore nuk janë çelur për shkak të mosformimit të trupit gjykues rezultojnë që seancat vijuese të jenë planifikuar në një kohë të afërt dhe janë marrë masa efektive për të siguruar vijimin pa vonesa të gjykimit. Në të gjitha rastet e tjera, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur kryesisht për shkaqe procedurale, të tilla si: mungesat e palëve, njoftimi i palëve me shpallje, shtyrja e seancës për të marrë prova, shtyrja e seancës për t'u njohur palët me provat e njëra-tjetrës, shtyrja e seancave për të siguruar palët praninë e avokatëve, shtyrja e seancave për të kryer suksesim procedural; për shkak të mos kryerjes së pagesës për aktin e ekspertimit; kryerjen e aktit të ekspertimit, me kërkesë të ekspertit për t'iu përgjigjur pyetjeve shtesë, përgatitja me shkrim e pretendimeve përfundimtare dhe për shpalljen e vendimit përfundimtar.

Përgjithësisht seancat gjyqësore janë planifikuar brenda një afati të arsyeshëm, nën 30 ditë, duke marrë në konsideratë volumin e punës në gjykatë, por në disa raste kur ky afat është kaluar, duke ka ndikuar leja vjetore e gjyqtarëve në muajin gusht, koha e mbartjeve të dosjeve në muajin janar, apo me kërkesë të vetë palës. Gjithashtu, është respektuar afati procedural 5 ditor kur seanca është shtyrë për përgatitjen e konkluzioneve me shkrim, sipas përcaktimeve të nenit 305 të K.Pr.Civile, apo shpalljen e arsytuar të vendimit, sipas përcaktimeve të nenit 308 të K.Pr.Civile, përveç kur ka qenë e pamundur për shkak të angazhimit të gjyqtarës në trajnimin vazhdues.

Pra, në tërësi, shtyrjet e seancave kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjyqtarës së çështjes.

Referuar sa më sipër, për treguesin e “*Numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short,⁵¹ rezultojnë se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është 8.1 seanca, por nga ana tjetër gjyqtarja në çdo rast ka treguar kujdes duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

Në lidhje me pikëzimin e këtij treguesi, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, veçanërisht masave për zhvillimin me efektivitet dhe produktivitet të seancave gjyqësore në çështjet e përzgjedhura me short, rezultojnë se gjyqtarja në çdo rast ka marrë të gjitha masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet. Prandaj pavarësisht se numri mesatar i seancave është më i lartë se 3, gjyqtarja duhet të pikëzohet

⁵¹Referuar Metodologjisë së Pikëzimit “*Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (civile, administrative, penale, dhe sipas shkallëve të gjykimit), duke përfshirë ato pa palë ndërgjyqëse*”.

me 15 pikë, sepse ajo ka treguar shkallë të lartë aftësie për shmangien e seancave gjyqësore joproductive.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është 8.1 seanca (më i lartë se 3), shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproductive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj gjyqtarja duhet të vlerësohet me 15 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se në lidhje me këtë tregues, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproductive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj gjyqtarja duhet të vlerësohet me 15 pikë.*

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe vendimet e administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “*Subjekti i rivlerësimit {...} Vlora ka aftësi mesatare për të kryer procedurat gjyqësore në katër dosjet e vëzhguara (më hollësisht shih analizën e dosjeve 1-4). Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa prej saj, por janë evidentuar probleme në organizimin dhe planifikimin e punës nga ana e saj, fakt që ka sjellë në tre raste zvarritje të gjykimit (shih analizën e dosjeve 1, 2 e 3). Gjyqtarja nuk disponon me vendim apo urdhër formal për vënien në lëvizje të çështjes (caktim seance përgatitore), por disponon me “shënim”, një veprim ky ekstraprocedural. Në katër çështje civile themeli të vëzhguara, gjyqtarja ka kryer rregullisht veprimet përgatitore (shih dosjet 1-4). Veprimet përgatitore janë dokumentuar rregullisht me procesverbal i mbajtur nga*

vetë gjyqtarja, por për fat të keq pothuajse të gjitha rastet, procesverbali i veprimeve përgatitore është mbajtur me një shkrim të palexueshëm... ”.

- Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Nga 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 10 prej tyre i përkasin kategorive të çështjeve civile me palë kundërshtare dhe 1 çështje i përket kategorisë së kërkesave penale të hetimit paraprak.

Gjyqtarja në përgjithësi i ka vënë në lëvizje çështjet, duke caktuar seancën përgatitore nga një ditë ose deri në 5 ditë pas caktimit të çështjes me short, duke iu referuar rregullave të gjykimit të çështjeve civile, por duke mos disponuar me vendim apo urdhër formal për vënien në lëvizje të çështjes (*caktim seance përgatitore*), por me “shënim” për sekretaren gjyqësore. Ndërsa në rastin e shqyrtimit të kërkesës me objekt vleftësim arresti e caktim mase sigurimi personal, gjyqtarja ka disponuar menjëherë me caktimin e seancës gjyqësore për marrjen në shqyrtim të saj. Gjyqtarja kryen rregullisht veprimet përgatitore, për të cilat është mbajtur procesverbal apo shënime me shkrim dore nga vetë gjyqtarja, të cilat fatkeqësisht thuhet janë të palexueshme (duke e bërë kështu të pamundur të kuptohet nëse nga gjyqtarja janë kryer veprime efektive përgatitore). Pas kryerjes së veprimeve përgatitore, gjyqtarja ka disponuar me vendim për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, i cili është i formalizuar si vendim më vete, i shkruar gjithashtu me shkrim dore. Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë mbajtur në shumicën e rasteve jashtë sistemit të regjistrimit audio (përveç një numri të vogël të seancave 2 apo 3 raste), pa u relatuar ndonjë shkak. Pavarësisht kësaj, seancat janë dokumentuar me procesverbal gjyqësor me shkrim të mbajtur nga sekretarja gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja përgjithësisht i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën dhe duke kryer njoftimet përkatëse për palët. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligji për gjykimin në shkallë të parë si në çështjet civile (*nenet 171 e vijues të K.Pr.Civile*) dhe në kërkesën penale (*nenet 259 dhe 341 të K.Pr.Penale*), ashtu edhe në çështjen penale.

Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve dhe përfaqësuesve të tyre, relativimin e akteve të njoftimit dhe marrjen ose jo dijeni nga palët që nuk janë paraqitur, disponimin me vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e gjykimit në mungesë, në rastet e mosparaqitjes së palëve pa shkaqe të përligjura, shpalljen e trupit gjykues, dhënien e fjalës palëve për kërkesa paraprake, disponimin me vendim për kërkesat paraprake të palëve në rastet kur paraqiten kërkesa të tilla, deklarinimin të hapur të

shqyrtimit gjyqësor, dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave, administrimin e provave, drejtimin dhe orientimin e debatit mbi provat, si dhe mbi elementë proceduralë të zhvillimit të gjykimit, dhënien e fjalës palëve lidhur me vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor pas zhvillimit të debatit mbi provat, deklarimin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor, dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e diskutimit përfundimtar, tërheqjen e gjykatës për marrjen e vendimit dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

Në shumicën e dosje te vëzhguara, nuk ka informacion të saktë për kohën kur janë çelur seancat e planifikuara, duke qenë se ato përgjithësisht janë mbajtur jashtë regjistrimit audio, por edhe në rast vonesash, të cilat në disa raste janë relatuar dhe përgjithësisht nuk kanë qenë të gjatë, nuk rezulton që të jenë bërë shkak për mos zhvillimin e seancës së planifikuar.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja përgjithësisht ka treguar shkallë aftësie shumë të lartë në treguesin “Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, aftësi të cilat reflektohen në mënyrë të plotë në çështjet e analizuara, duke ndjekur me korrektësi planifikimin, mbikëqyrjen, zhvillimin dhe dokumentimin e veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit civil në seancat gjyqësore të zhvilluara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi : Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 20 pikë.

2.C. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe vendimet e administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “...Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, nuk janë konstatuar mangësi serioze në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikqyruar saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Si mangësi konstatohet fakti se gjyqtare {...} Vlora, nuk nxjerr vendim formal apo urdhër me shkrim për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Gjyqtarja disponon me “shënim”, një veprim ky jo i rregullt proceduralisht. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesëpadia apo kërkesa penale për gjykim, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare, fletëthirrjet, provat, vendimi përfundimtar etj”.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se dosjet janë renditura në mënyrë të rregullt, duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 11 dosjet e vëzhguara, duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e dosjes në çështjet civile fillon me padinë dhe provat e paraqitura nga palët, aktet e njoftimit të palëve, vijon shënimin e bërë nga gjyqtarja për caktimin e seancës përgatitore, procesverbalet e seancave përgatitore, vendimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, kërkesat dhe parashtrimet me shkrim të palëve gjatë gjykimit, procesverbalet e seancave gjyqësore, konkluzionet me shkrim të paraqitura nga palët dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar. Në të gjitha çështjet burim vlerësimi konstatohet mungesa e vendimit apo urdhërit formal për caktimin e seancës përgatitore, duke u përdorur vetëm një “shënim” administrativ, veprim i cili nuk është i rregullt në aspektin formal ligjor, për sa kohë që gjykata disponon vetëm me urdhëra dhe vendime.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave. Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

KONKLUZIONI

Në tërësi, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin logjik (sipas kategorisë) dhe kronologjike (brenda së njëjtës kategori aktesh), është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi. Ndërsa vlerësoj se mangësia e vërejtur tek dosjet e gjyqtare, në lidhje me mungesa e një vendimi apo urdhëri formal për caktimin e seancës përgatitore, që

lidhet me aspektin formal nuk duhet të ndikojë në pikëzimin e gjyqtares lidhur me këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 5 pikë.

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se *“Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit, me përjashtim të procesverbalit të veprimeve përgatitore që sikurse kemi pasqyruar më lart, është pothuajse i palexueshëm shkrimi”*.

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo veprim apo seancë, shkresat drejtuar institucioneve, procesverbalet e çdo seancë përgatitore apo gjyqësore, si dhe vendimi përfundimtar) si dhe aktet e paraqitura nga palët (aktet e përfaqësimit të palëve, provat e administruara në të cilën përfshihet edhe akti i ekspertimit nëse është lejuar marrja e provës me ekspert, diskutimet përfundimtare të palëve, etj). Nuk konstatohet mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
93	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për treguesit e këtij kriteri bëhet në rend zbritës, dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar këtij kriteri vlerësimi, duke zbritur sipas rastit pikët në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues sipas burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë tregues në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe procedimeve disiplinore, konstatohet se në periudhën 08.10.2013-08.10.2016, në Inspektoriatin e ish-KLD-së, nuk është paraqitur asnjë ankesë për shkelje etike për gjyqtaren {...} Vlora. (shih të dhënat nga Burimet Arkivore të KLGJ-së). Nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës {...} Vlora”.

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;

- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Në relacionet e hartuara nga Inspektorati i KLD dhe në vendimin e ILD-së nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtares.

Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 540, datë 10.06.2022, rezulton se KPK nuk ka evidentuar dhe as ka shqyrtuar elementë që mund të ndikonin në vlerësimin lidhur me etikën e gjyqtares.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të etikës në punë.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e etikës së gjyqtares në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARES

Lidhur me këtë tregues, në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} Vlora {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm”.

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtaren {...} Vlora ({...}) janë paraqitur gjithsej 5 (pesë) ankesa në Inspektoratin e ish KLD.⁵² Në materialet për verifikimin e ankesave rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga vendimin e KPK-së, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se; “*Nga vlerësimi në tërësi i pasurive të subjektit të rivlerësimit ka rezultuar se subjekti ka deklaruar saktë pasuritë në deklaratën Vetting dhe nuk janë konstatuar elemente që mund të ngrenë dyshime për fshehje pasurie apo deklarim të rremë. Ndërkohë, subjekti ka justifikuar me të ardhura të ligjshme pasuritë e krijuara gjatë periudhës së rivlerësimit.*

*Komisioni, duke vlerësuar në tërësi çështjen, për një vlerësim sa më objektiv, duke marrë në konsideratë të gjitha konstatimet e arsyetuara sa më sipër, të cilat passjellin pasaktësi në deklarimin e subjektit lidhur me burimet e ligjshme që kanë shërbyer për investimet në pasurinë e saj dhe të bashkëshortit në raport edhe me deklaratimet e tjera që lidhen me kriterin e pasurisë, si dhe në vlerësim të përgjithshëm të dy kriterëve të tjera të rivlerësimit, çmon se proporcionalisht këto konstatime, si një shkak i vetëm dhe i veçuar, nuk janë të mjaftueshme për t’u konsideruar si deklarim i pamjaftueshëm dhe që mund të çonte subjektin drejt aplikimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016”.*⁵³

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr.540, datë 10.06.2022, janë shqyrtuar dhe vlerësuar elementë

⁵²Sikurse pasqyrohet në pjesën e dytë të këtij Projektraporti, të titulluar “Burimet e vlerësimit”

⁵³ faqe 27

në lidhje me integritetin e gjyqtares, të cilët pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit figurës, janë gjetur të pabazuara duke konkluduar se: *Nga hetimi administrativ, edhe pas përditësimit të të dhënave të ardhura nga autoritetet verifikuese, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës*".⁵⁴

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtares.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të integritetit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj.

Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e integritetit të gjyqtares në treguesin "Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti" është "Shumë e lartë", dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C PAANËSIA E GJYQTARES

Lidhur me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se "Nga 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit {...} Vlora, nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme".

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);

- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Referuar akteve burim vlerësimi, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga ana e gjyqtares.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtares në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat statistikore.

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Për vetë gjyqtaren {...} Vlora, nuk u konstatua asnjë kërkesë për përjashtimin e saj nga gjykimi në 5 dosjet e vëzhguara”

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të

gjqtares, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ), si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares në periudhën e vlerësimit.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtares. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, në kushtet kur në rastet e gradimit zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Ligjit për Statusin, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares është i pakonsiderueshëm.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares. Prandaj, për këtë tregues vlerësohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares është i pakonsiderueshëm.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër është “I pakonsiderueshëm”.*

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarës në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

Lidhur me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: *“Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja {...} Vlora komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë”.*

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Referuar vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim, akteve të çështjeve të përzgjedhura me short dhe vendimeve të administruara për shkak të ankesave (*kryesisht procesverbaleve të seancave, përfshirë këtu regjistrimet e seancave me mjete audio, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore*) rezulton se gjyqtarja gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarës për të qartësuar kërkimet e palëve apo për të orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i saj është i drejtpërdrejtë dhe konkret, në lidhje me çështjen për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe e drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë dhe koncize, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Referuar vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim, akteve të çështjeve të përzgjedhura me short dhe vendimeve të administruara për shkak të ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “E lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se; “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e gjyqtarës {...} Vlera për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Nuk janë evidentuar raste të shpeshta, që të ketë pasur vonesa në fillimin e seancave gjyqësore, apo vonesa të dukshme në arsyetimin e vendimeve, gjq që tregon se bashkëpunimi i saj me administratën gjyqësore dhe kolegët në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur”.

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarës gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, shërbejnë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarës dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për mungesë të bashkëpunimit me kolegët, për rrjedhojë, prezumohet se ky komunikim është në nivel të lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit

dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burim vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtares dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për rrjedhojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkallë të ulët të komunikimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhënë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se aftësia e gjyqtares në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARES PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

Lidhur me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se ;“...*Subjekti i rivlerësimit {...} Vlora, i nënshtrohet detyrimisht programit të të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhë të rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 8 seminare të organizuara nga Shkollat Magjistraturës (shih të dhënat tek Trajnimet në 3 vitet e fundit). Këto të dhëna tregojnë se ajo ka marrë pjesë në 14 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve ku ajo ka marrë pjesë, ka lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë. Znj. {...} Vlora i ka kushtuar vëmendje edhe thellimit të njohurive profesionale pasi gjatë ushtrimit të detyrës së gjyqtarit, ajo ka kryer edhe Master Profesional, në fushën e së drejtës civile. Më konkretisht, ajo është vlerësuar me Certifikatën “Student i shkelqyer”, lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, për studimet e kryera në programin “Master i Nivelit të dytë në Shkencat Civile”, në periudhën 2010-2011”.*

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARES NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDIET TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtares.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, vërtetimit të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtarëve, së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se ajo ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrjes.

Konkretisht, referuar akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe vërtetimit me nr.433/1 prot., datë 21.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës, gjyqtarja {...} Vlora ({...}) është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e pjesëmarrjes në 8 aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 14 ditë trajnimi.

Në formularin e vetvlerësimit gjyqtarja ka deklaruar se ka kryer edhe trajnime jashtë Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, të cilat paraqiten si më poshtë;

- Danida Felloëship Programme - periudha 15.09.1997-10.10.1997, Kopenhaggen Danimarkë.

-Internacional Development Laë Institute (IDLI) periudha pergjate viteve 2000- 2001, Durres Shqiperi.

-Internacional Center for non profit Laë(ICNL) periudha 17.11.2002- 24.11.2002, Budapest Hungari.

-International Center for Judicial Studies periudha 18.10.2003-30.10.2003, Kajro Egjipt.

Sa më sipër, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë edhe në aktivitete të tjera trajnuese, jashtë programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, por që nuk i përkasin periudhës së vlerësimit dhe si e tillë këto trajnime nuk mund të merren në konsideratë.

Lidhur me pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese, Ligji nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në fuqi në periudhën e vlerësimit, nuk përmbante një parashikim lidhur me detyrueshmërinë e pjesëmarrjes së gjyqtarit në aktivitete trajnuese. Ndërkohë ky detyrim parashikohej në nenin 23 të ligjit nr. 8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas të cilit *gjyqtarët dhe prokurorët e gjykatave e të prokurorive të shkollës së parë dhe të gjykatave të apeleve i nënshtrohen formimit vazhdues. Periudha e formimit vazhdues nuk duhet të kalojë më shumë se 20 ditë në vit dhe jo më shumë se 60 ditë gjatë pesë vjetëve.*

Aktualisht, në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 5 të tij, pjesëmarrja në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës është përcaktuar si e drejtë dhe njëkohësisht detyrim i gjyqtarit, duke përcaktuar edhe kufirin minimal dhe maksimal të pjesëmarrjes gjatë një viti si dhe gjatë

pesë viteve⁵⁵. Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues përcaktohet se gjyqtarët kanë detyrimin ligjor të ndjekin programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Gjyqtari duhet t'i kushtojë kohë evoluimit të mendimit juridik dhe jurisprudencës dhe të ndjekë programe trajnimi që nxitin specializimin e tij të organizuara edhe nga institucione të tjera trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli. Në lidhje me pikëzimin e aftësisë së gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, treguesi i pjesëmarrjes në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, matet duke u bazuar në informacionin me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në trajnime. Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime të tjera vlerësohet bazuar në dokumente të dorëzuara prej tij që tregojnë ngritjen profesionale.

Referuar sa më sipër, pavarësisht se ligji nr. 96/2016 dhe Metodologjia e Pikëzimit miratuar me vendimin nr. 264, datë 21.11.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk kanë qenë në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar nenit 23 të ligjit nr. 8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas formulimit të tij në periudhën e vlerësimit, rezulton se pjesëmarrja e gjyqtarit në Programin e Formimit Vazhdues të Sh. M ka qenë e rregulluar nga ky ligj, duke përcaktuar vetëm kufirin maksimal të angazhimit për 1 dhe 5 vjet dhe jo një detyrim minimal pjesëmarrje.

Sa më sipër, referuar të dhënave lidhur me angazhimin e gjyqtarës {...} Vlora ({...}), ku rezultoi se gjyqtarja ka marrë pjesë në 8 aktivitete trajnuese në programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, të cilat kanë zgjatur në tërësi për 14 ditë trajnim, gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016, pikëzimi për këtë tregues, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, do të jetë me 20 pikë, pavarësisht se për periudhën 3 vjeçare rezulton vetëm për 8 aktivitete trajnuese me gjithsej 14 ditë trajnimi. Kjo pasi legjislativi i kohës parashikonte vetëm kufirin maksimal të pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese, por jo një kufi minimal pjesëmarrje në aktivitete trajnuese, sikurse përcaktohet aktualisht në nenin 5, të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

⁵⁵ Në nenin 5 të Ligjit nr. 96/2016, parashikohet se :” 1. Magjistrati ka të drejtë dhe detyrimin të marrë pjesë në programet e formimit vazhdues. Magjistrati ka të drejtë të propozojë tema trajnimi dhe të bashkëpunojë me Këshillin, me qëllim përmirësimin e programeve të trajnimit. 2. Magjistrati duhet: a) të ndjekë formimin vazhdues, në përputhje me legjislativin në fuqi; b) të marrë çdo masë tjetër të arsyeshme për t'u përditësuar me ndryshimet legjislative dhe të jurisprudencës. 3. Periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve. 4. Magjistrati duhet të përmbushë detyrimin për të marrë pjesë në formimin vazhdues vetëm në ato raste kur programet e trajnimit janë: a) të përshtatshme për funksionin e tij; b) të organizuara dhe certifikuara nga Shkolla e Magjistraturës ose nga çdo institucion trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar të njohur nga Këshilli. Një kopje e certifikatës vendoset në dosjen personale të magjistratit.”

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin së drejtës civile, gjithsej 8 aktivitete të zhvilluara për 14 ditë trajnim.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime të tjera profesionale është brenda kufijve të legjislacionit të kohës duke u pikëzuar me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARES PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtares në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtarit, nuk rezulton të jetë referuar për angazhimin e saj në veprimtari trajnuese si eksperte ose lehtësuese në programin e Shkollës së Magjistraturës, apo të ndonjë institucioni tjetër për gjyqtarët.

Lidhur me disponueshmërinë e gjyqtares për të udhëhequr kandidatë për magjistratë, nuk rezulton që tek gjyqtarja {...} Vlora të jenë caktuar kandidatë për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtaren {...}, duke qenë se nuk ka të dhëna, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si eksperte/lehtësuese dhe as angazhimi i saj për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë vitit të stazhit profesional.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARES NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtarit, si dhe akteve të paraqitura nga gjyqtarja lidhur me këtë tregues, rezulton që gjyqtarja për periudhën e vlerësimit 2013-2016 nuk është angazhuar në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë, siç janë; fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtaren {...} Vlora ({...}) ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera gjatë periudhës së vlerësimit.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtares, nuk rezulton që gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit të ketë realizuar publikime ligjore akademike, me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit vlerësohet se për gjyqtaren {...} Vlora ({...}) ky tregues duhet të pikëzohet me 0 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, duhet të pikëzohet me 0 pikë për këtë tregues.

Angazhimi i gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Publikime ligjore akademike” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
91	Shkëlqyeshëm

**PWRCAKTIMI I NIVELIT TW VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI
DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT**

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtares	90	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtares	93	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	374	Shkëlqyeshëm

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1

**KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 2013-2016**

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES			Pikët total	Niveli i vlerësimit	
			90	Shkëlqyeshëm	
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë	
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Mbi mesataren	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short 	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë

		pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short)			Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Mbi mesataren	12	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë	
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Mbi mesataren	8	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë	
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES				Pikët total		Niveli i vlerësimit
				93		Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i	Pikët	Metodologjia	

			treguesit		
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	11-20%	12	Jashtë afatit: Mbi 40% - 3 pikë 31-40% - 6 pikë 21-30% - 9 pikë 11-20% - 12 pikë 0-10% - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	11-20%	4	Jashtë afatit: Mbi 40% - 1 pikë 31-40% - 2 pikë 21-30% - 3 pikë 11-20% - 4 pikë 0-10% - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve	4	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë

					me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit 	Mbi 93-99%	8	Tej standardit : Nën 81%- 2 pikë Mbi 81-87% - 4 pikë Mbi 87- 93% - 6 pikë Mbi 93-99% - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); ▪ Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar 	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	15	Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë

B. Aftësia e gjyqtares për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtares: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit 	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtares: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i gjyqtares	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit 	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtares : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
C. Paanësia e gjyqtares	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë

	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares	▪ Dosja e rivlerësimit	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				91	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short)	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparenca e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short)	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke	▪ Dosja e rivlerësimit	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë

	përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta				Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	▪ Dosja e rivlerësimit	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtarës për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarës në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	▪ Dosja e rivlerësimit	15-120 ditë	20	Pjesëmarrja e gjyqtarës: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	▪ Dosja e rivlerësimit	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Angazhimi i gjyqtarës në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	▪ Dosja e rivlerësimit	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimet ligjore akademike	▪ Dosja e rivlerësimit	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë

PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT	374
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARES	Shkëlqyeshëm

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR